# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5522
E martë, 10 korrik 2018
çmimi 0.40 €

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"


## Pacolli: Është koha e marrëveshjes përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë




FAQE 6


AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", GJENERALLEJTËNANT RRAHMAN RAMA FAQE 4-5

# Largimi i pjesëtarëve serbë nuk ndikon në transformimin e FSK-së



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka shprehur shqetësim me rastin e largimit të mbi 40 pjesëtarëve serbë nga kjo forcë. Megjithatë, në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ai ka bërë me dije se largimi i pjesëtarëve serbë nuk do të ketë ndikim në transformimin e FSK-së. Rama ka treguar se ka të interesuar të tjerë dhe shumë shpejt do të plotësohet numri i të dorëhequrve. Ai ka thënë se, sipas procedurave, këta pjesëtarë duhet të presin nga një deri në gjashtë muaj derisa t'u miratohet kërkesa e njëanshme për largim. Rama ka bërë me dije se të gjithë ata që nuk dëshirojnë të jenë pjesë e FSK-së do t'u shkëputet kontrata bazuar në kodin disiplinor. Ai ka deklaruar se FSK-ja do të vazhdojë të jetë gjithëpërfshirëse dhe e gatshme për ta kryer misionin e vet



## Veseli: LDK-ja për inate po e pengon konsensusin kombëtar

Kryeparlamentari Kadri Veseli e ka kritikuar të hënën Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), duke thënë se ajo po e pengon arritjen e konsensusit kombëtar për fazën finale të dialogut me Serbinë. Ai ka bërë me dije se LDK-ja këtë po e bën vetëm për inat që nuk është në pushtet. Kreu i Kuvendit ia ka rikujtuar LDK-së se me këto veprime inatçore e ka lënë edhe Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) pa u bërë ushtri FAQE 3

## Mungojnë deputetët, shtyhet votimi i Projektligjit të Gjykatës së AKP-së



Deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk kanë arritur të hënën ta miratojnë Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për shkak të mungesës së deputetëve në procesin e votimit FAQE 7

### AKTUALE

**DIALOGU I PAMBARUAR** F. 10



Hysni GUCATI

**PROBLEME THEMELORE TË PUNIMEVE STUDIMORE (5)** F. 11



Hajdin ABAZI

**KUVENDI I KOSOVËS BËHET ANËTAR I ASAMBLESË SË FRANKOFONISË** F. 7

### EKONOMI

**PUNËTORËT E POSTËS SË KOSOVËS NDËRPRESIN GREVËN** F. 8

**MPMS-JA E GIZ-i OFROJNË MUNDËSI PUNËSIMI PËR 400 PUNËKËRKUES NGA KOSOVA** F. 9

### KULTURË

**DEKADA TË PUNËS SË FRYTSHME SHKENCORE** F. 13

Prof. dr. Hysen MATOSHI

### SPORT

**DRITA KËRKON MAKSIMUMIN NDAJ MALMOS** F. 16


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
Mob.: +377(0) 44 506 815
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Pacolli: Është koha e marrëveshjes përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë



LONDËR, 9 KORRIK - "Dialogu ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë ka sjellë përparim dhe rezultate pozitive, por është koha të flasim për marrëveshje përfundimtare, e cila do të jetë në të mirë të të dy vendeve" ka thënë zëvendëskryeministri i Qeverisë së Kosovës, njëherësh ministër i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, në sesionin e Samitit të Londrës, që është pjesë e "Procesit të Berlinit".
Siç njofton Ministria e Punëve të Jashtme, kryediplomati i Kosovës ka prezantuar prioritetet dhe të arriturat e Qeverisë së Kosovës, ndërsa ka vlerësuar lart kontributin që ka dhënë iniciativa e vendeve të Ballkanit Perëndimor, e njohur si "Procesi i Berlinit", për përshpejtimin e krijimit të kushteve infrastrukturore për zhvillim ekonomik si dhe për paqësimin e mëtutjeshëm të rajonit përmes bashkëpunimit konstruktiv.
Në margjina të Samitit të Londrës numri dy i Qeverisë ka zhvilluar takime të shumta me përfaqësues të niveleve të larta nga shtete të ndryshme që po marrin pjesë në këtë ngjarje.

# Xhaferi: Dekretimi i marrëveshjes për emrin, pas konkluzionit të Qeverisë

SHKUP, 9 KORRIK - Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, nuk e ka përjashtuar mundësinë që Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes në mes të Maqedonisë dhe Greqisë ta kthejë në Qeveri, duke e njoftuar ekzekutivin se presidenti Gjorge Ivanov nuk do ta firmosë ligjin as për të dytën herë. Ai ka thënë se Kuvendi do të kërkojë edhe një mendim nga Qeveria për nevojën e këtij ligji. "Për aspekt formal, për t'u sqaruar Qeveria se a qëndron mbi



ato propozime që i ka adresuar paraprakisht në Kuvend dhe janë miratuar, unë nuk e kam atë problem që edhe formalisht t'i drejtohem propozuesit të dy ligjeve. Por, sidoqoftë, për aspektin formal që të mund ta sigurojmë jetën e ligjeve, ne do t'i zbatojmë të gjitha arsyet dhe argumentet që pala e caktuar po i propagandon dhe sqaron para opinionit, dhe për mua nuk ka asnjë problem për ta bërë atë edhe formalitet", ka thënë Xhaferi.

# Gashi: Terrorizmi dhe ekstremizmi, kërcënimet kryesore të sigurisë

PRISHTINË, 9 KORRIK (ER) - Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, po merr pjesë në Samitin e Londrës, në kuadër të Procesit të Berlinit, ku po marrin pjesë ministrat e brendshëm të Ballkanit Perëndimor dhe përfaqësues të shteteve të Procesit të Berlinit dhe të institucioneve në fushën e sigurisë.
Në këtë samit ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, duke diskutuar çështjet ndërsektoriale të sigurisë, vuri në dukje përpjekjet që po bën Republika e Kosovës sa i përket luftës kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
Me këtë rast ministri Gashi ka theksuar se terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm vazhdojnë të mbeten kërcënimet kryesore të sigurisë, duke kërcënuar jo vetëm jetën dhe pronën, por edhe vlerat demokratike dhe mënyrën e jetesës së shoqërisë.
Ai ka thënë se trendi global i terrorizmit dhe



shtrirja e tij, sidomos gjatë dy dekadave të fundit, ka kërcënuar gjithë rajonin, Evropën dhe më gjerë. "Qeveria e Kosovës dhe institucionet e saj të specializuara do të vazhdojnë ta luftojnë deri në fund këtë të keqe të madhe të njerëzimit", ka thënë ministri Gashi.

## Erdogani u betua për mandatin e ri

ANKARA, 9 KORRIK - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, u betua të hënën për mandatin e ri. "Betohem me nderin tim, përpara kombit të madh turk dhe historisë së tij, se do të punoj, me gjithë fuqinë, për ta mbrojtur dhe lartësuar lavdinë e Republikës së Turqisë", ka thënë Erdogani në Kuvend.
Erdogani është rizgjedhur president në zgjedhjet e 24 qershorit me 52.2 për qind të votave. Ndryshimet i japin Erdoganit kompetenca të reja, përfshirë të tilla mbi gjyqësorin, si dhe mundësinë për të sunduar me dekret.

## Boris Johnsoni jep dorëheqje

LONDËR, 9 KORRIK - Boris Johnson ka dhënë dorëheqje nga posti i sekretarit të jashtëm britanik. Ai është ministri i dytë i kabinetit që tërhiqet për shkak të strategjisë për "Brexit"-in, apo procesin e daljes së Britanisë nga Bashkimi Evropian.
Të dielën vonë ka dhënë dorëheqje edhe ministri për "Brexit", David Davis. Ai pati deklaruar se nuk mund të qëndronte më në postin e tij sepse nuk besonte në planin për marrëdhëniet e ardhshme të Mbretërisë së Bashkuar me BE-në, i cili u mbështet nga kabineti britanik javën e kaluar.

## Vulini: Dërgimi i oficerëve malazezë në Kosovë nuk është akt miqësor

BEOGRAD, 9 KORRIK - Ministri i Mbrojtjes i Serbisë, Aleksandar Vulin, ka thënë se dërgimi i dy ushtarëve malazezë në misionin paqeruajtës të KFOR-it në Kosovë ka të bëjë me mbrojtjen e pavarësisë së Kosovës dhe jo me mbrojtjen e serbëve. Ai ka thënë se vendimi i tillë i Podgoricës, pa u konsultuar me Serbinë, "nuk është akt miqësor". "Ka qenë e udhës që Mali i Zi të konsultohet me Serbinë për këtë çështje, të tregojë respekt për shtetin e Serbisë me të cilin duhet të jetojë. Kur jeni fqinjë, është e logjikshme të tregoni kujdes për interesat e atij që jeton pranë jush", ka thënë Vulin. Ditë më parë Kuvendi i Malit të Zi vendosi të dërgojë dy oficerë në kuadër të KFOR-it - mision paqeruajtës i NATO-s. Autoritetet malazeze thanë se prania e tyre në KFOR do të kontribuojë në stabilitetin dhe sigurinë e rajonit.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka bërë thirrje për konsensus kombëtar për temat që e presin vendin

# Veseli: LDK-ja për inate po e pengon konsensusin kombëtar

Kryeparlamentari Kadri Veseli e ka kritikuar të hënën Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), duke thënë se ajo po e pengon arritjen e konsensusit kombëtar për fazën finale të dialogut me Serbinë. Ai ka bërë me dije se LDK-ja këtë po e bën vetëm për inat që nuk është në pushtet. Kreu i Kuvendit ia ka rikujtuar LDK-së se me këto veprime inatçore e ka lënë edhe Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) pa u bërë ushtri



EPOKA E RE Muhamet KOCI

Prishtinë, 9 korrik - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka ftuar edhe një herë subjektet opozitare për konsensus kombëtar për fazën e fundit të dialogut me Serbinë. Ai e ka kritikuar subjektin më të madh opozitar, Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), se është duke bllokuar arritjen e këtij konsensusi. Sipas tij, LDK-ja po vepron kështu vetëm për inat që nuk është në pushtet. "Le të dalë Isa dhe ta marrë bajrakun. Por, për ta bllokuar çdo proces për inate që nuk është në pushtet, kjo nuk është korrekte", ka thënë Veseli në një konferencë për medie mbajtur të hënën pas takimit që ka pasur me kreun e Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu.

Veseli ka bërë me dije se konsensusi kombëtar është i domosdoshëm për Kosovën, duke theksuar se askush nuk duhet t'i druhet këtij procesi të dialogut. Sipas tij, në këtë proces dialogues po shkohet në Bruksel për t'iu siguruar gjeneratave të ardhshme një perspektivë të sigurt evropiane. "Çështja e konsensusit është e domosdoshme. Çdo veprim institucional që do të ndërmerret do të kalojë përmes Kuvendit. Për këtë çështje jemi takuar me presidentin dhe kryeministrin. Sot kemi një bllokadë për arsye inati. Kështu si po ecet do të na vonojnë tre apo katër muaj", është shprehur ai. Veseli ka theksuar se Kuvendi do ta ketë rolin e plotë në dialog. "Kjo nuk ka asnjë mëdyshje. Ky është një pajtim mes partnerëve të koalicionit qysh në fillim", është shprehur Veseli.

Më tej, kreu i Kuvendit ka deklaruar se me këto vonesa Kosova po humbet kohë. Ai ka pranuar se çdoherë takimet e Kosovës me Serbinë janë sfiduese. "Jemi duke humbur kohë, jemi duke e dëmtuar vetveten, jemi duke u marrë me bajraktarizma, në vend se të merremi me atë për çfarë kemi për t'u ballafaquar, pra me një sfidë e cila nuk është e lehtë. Serbia asnjëherë nuk ka qenë e lehtë për Kosovën", është shprehur Veseli, duke shtuar se me këto veprime po humbet opozita. "E kam një përshtypje se opozita po vazhdon të gabojë njëjtë. Çështja e transformimit të FSK-së sot do të kishte përfunduar nëse nuk do ta kishim këtë inatin e opozitës", ka deklaruar Veseli.

Sipas kryeparlamentarit, konsensusi kombëtar do ta ndihmonte Kosovën të dalë fitimtare në këtë proces. "Opozita duhet t'i bashkëngjitet këtij karvani, sepse kur kemi qenë bashkë kemi fituar më shumë. Ky pozicion, bukur inatçor i LDK-së, është duke e dëmtuar Kosovën. E ka dëmtuar edhe FSK-në, edhe demarkacionin. Po frikësohemi se njëjtë do të ndodhë edhe tash për dialogun", është shprehur Veseli.

Kryetari i Kuvendit ka folur edhe për procesin e liberalizimit të vizave, duke shprehur optimizëm se rekomandimi i Komisionit Evropian do të jetë pozitiv për Kosovën. "Liberalizimi i vizave duhet të ndodhë sepse e meritojmë. Në aspektin institucional i kemi përmbushur të gjitha kriteret. Unë e kam parë një skepticizëm brenda BE-së i cili vjen si rezultat i mosmarrëveshjeve brenda këtij institucioni rreth krizës së refugjatëve. Megjithatë, presim raport pozitiv", ka thënë Veseli.

Ai ka deklaruar se ka disa vende që janë më keq se Kosova në aspektin e korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe qytetarët e tyre lëvizin lirshëm në Zonën Shengen.

# Haradinaj kërkon mbështetjen e Britanisë për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare

Londër, 10 korrik (ER) - "Kosova dhe Mbretëria e Bashkuar kanë ndërtuar marrëdhënie të shkëlqyera dhe grupi i miqësisë parlamentare Kosovë - Mbretëri e Bashkuar është dëshmi e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve mike", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në takimin me grupin e miqësisë parlamentare Kosovë - Mbretëri e Bashkuar, me anëtarët e parlamentit, Martin Vickers, udhëheqës i Grupit të Miqësisë, John Grogan, bashkëudhëheqës i Grupit dhe Ian Paisely.

Kryeministri Haradinaj i njoftoi parlamentarët me progresin e Kosovës, me përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për zhvillim ekonomik, për tërheqjen e investitorëve të huaj, për hapjen e vendeve të reja të punës dhe për rrugën euroatlantike të saj, duke theksuar se Kosova është e interesuar ta zgjerojë partneritetin ekonomik. "Grupet e miqësisë së mirë në parlamentet tona janë bazë e mirë për kultivimin e raporteve të mira dhe partneritetit me Britaninë e Madhe", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke theksuar se bashkëpunimi i mirë me Qeverinë e Kosovës e siguron stabilitetin politik mes të dy vendeve.

Duke folur për lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës dhe duke kërkuar mbështetjen për liberalizimin e vizave, kryeministri Haradinaj u ka thënë parlamentarëve nga Mbretëria e Bashkuar se me liberalizimin e vizave vendet perëndimore do të kenë më shumë ekonomi dhe më shumë këmbime. "Mbështetja e Mbretërisë së Bashkuar në çastet vendimtare ka qenë shumë e rëndësishme për Kosovën, prandaj populli dhe Republika e Kosovës u janë mirënjohës", ka deklaruar kryeministri Haradinaj, duke kërkuar edhe më tej mbështetjen e shtetit britanik për anëtarësimin e Kosovës



në organizata ndërkombëtare dhe për thellimin e bashkëpunimit në rrafshin ekonomik dhe politik.

Gjatë takimit kryeministri Haradinaj ka folur edhe për mundësinë e zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet bizneseve angleze dhe atyre që udhëhiqen nga diaspora shqiptare në Mbretërinë e Bashkuar.

Flet për "Epokën e re", gjenerallejtënant Rrahman Rama

# Largimi i pjesëtarëve serbë nuk n

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka shprehur shqetësim me rastin e largimit të mbi 40 pjesëtarëve serbë nga kjo forcë. Megjithatë, në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ai ka bërë me dije se largimi i pjesëtarëve serbë nuk do të ketë ndikim në transformimin e FSK-së. Rama ka treguar se ka të interesuar të tjerë dhe shumë shpejt do të plotësohet numri i të dorëhequrve. Ai ka thënë se, sipas procedurave, këta pjesëtarë duhet të presin nga 1 deri në 6 muaj derisa t'u miratohet kërkesa e njëanshme për largim. Rama ka bërë me dije se të gjithë ata që nuk dëshirojnë të jenë pjesë e FSK-së do t'u shkëputet kontrata bazuar në kodin disiplinor. Ai ka deklaruar se FSK-ja do të vazhdojë të jetë gjithëpërfshirëse, kredibile dhe e gatshme për ta kryer misionin e vet



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 9 KORRIK - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka thënë të hënën se deri më tani mbi 40 pjesëtarë të kësaj force nga komuniteti serb kanë bërë kërkesë për largim për shkak të presioneve dhe kërcënimeve nga Serbia. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se këta pjesëtarë duhet të presin nga 1 deri në 6 muaj derisa t'u miratohet kërkesa e njëanshme për largim. "Prej momentit që pjesëtarët e FSK-së kanë kërkuar demobilizim, shkëputje të kontratës, derisa të marrin përgjigje janë të obliguar të lajmërohen në punë. Nëse dy ditë nuk lajmërohen në punë, bazuar në ligj, fillon masa tjetër disiplinore, mbledhja e bordit dhe merrja e vendimit për largim të tyre", është shprehur Rama, duke shtuar se 29 prej të dorëhequrve të hënën janë lajmëruar në punë.

Ai ka thënë se pjesëtarët që kanë vendosur të largohen nga FSK-ja janë të obliguar t'i kthejnë pajisjet individuale apo kolektive. "Nuk ka lëshim pe në kuptimin e thyerjes së rregullave dhe disiplinës. Të gjithë atyre që nuk dëshirojnë të jenë pjesë e FSK-së do t'u shkëputet kontrata bazuar në kodin disiplinor. Në FSK të gjithë janë të barabartë dhe do t'u nënshtrohen rregulloreve dhe kodit disiplinor", ka theksuar Rama. Ai ka treguar se për çështjen e presioneve dhe kërkesave për largim janë të njoftuar të gjithë partnerët e FSK-së, përfshirë edhe NATO-n.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama ka bërë me dije se largimi i pjesëtarëve serbë nga kjo forcë nuk do të ketë ndikim në transformimin e FSK-së. Ai ka treguar se ka të interesuar të tjerë dhe shumë shpejt do të plotësohet numri i të dorëhequrve. "Jo, nuk do të ndikojnë. Ky është një proces krejtësisht i ndarë. Jemi duke i kryer obligimet dhe punët tona. Ne e kemi bërë më të mirën e mundshme duke qenë institucioni shembull në vend, por edhe për shumë vende të rajonit jemi lider sa i përket përqindjes së komuniteteve në FSK. FSK-ja do të vazhdojë të jetë gjithëpërfshirëse, kredibile si dhe është e gatshme ta kryejë misionin e vet. Prandaj nuk shoh se këto largime do të kenë ndonjë ndikim në tranzicionin e FSK-së", ka deklaruar ai.

**"Epoka e re":** *Z. Rama, si e komentoni kërkesën për largim të dhjetëra pjesëtarëve të komunitetit serb nga Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) për shkak të presioneve nga Beogradi?*

**Rama:** Është e vërtetë se disa pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) nga komuniteti serb, për shkak të presioneve, kanë ofruar dorëheqje. Unë dy muaj më parë kam paralajmëruar për presionet dhe ndalesat në kufi me Serbinë që u janë bërë pjesëtarëve serbë të FSK-së. Presion nuk u është bërë vetëm pjesëtarëve të FSK-së, por edhe familjarëve të tyre. Prandaj, për shkak të këtij presioni, rreth 80 për qind e pjesëtarëve të komunitetit serb kanë ofruar dorëheqje, edhe pse jo me dëshirën e tyre.

**"Epoka e re":** *Sa është numri i atyre që përfundimisht kanë vendosur të largohen?*

**Rama:** Ende nuk dihet numri i saktë sepse ka lëvizje dhe ka disa prej tyre që dëshirojnë prapë të kthehen. Për numrin e saktë do ta informojmë opinionin në ditët e ardhshme. Deri më tani, ashtu siç edhe ka thënë edhe ministri, janë mbi 40 pjesëtarë të FSK-së nga komuniteti serb që kanë ofruar dorëheqje.

**"Epoka e re":** *Jeni duke komunikuar me këta zyrtarë për rikthimin e tyre?*

**Rama:** FSK-ja është forcë profesionale e cila funksionon sipas ligjit, rregulloreve dhe kodit disiplinor. Pavarësisht se kush janë, të gjithë ata që bien ndesh me rregulloren dhe kodin disiplinor do të merren masat ndaj tyre. Këtu nuk ka ndonjë dallim apo përjashtim. Këta kanë bërë kërkesë për demobilizim me vetëdëshirë në kuptimin e procedurave, prandaj nuk ka asnjë lëshim jashtë procedurave, pavarësisht se kush do të jenë ata.

**"Epoka e re":** *Cila është procedura që do ta ndiqni në këto raste?*

**Rama:** FSK-ja është organizatë vullnetare dhe këtu kemi të bëjmë me shkëputje të njëanshme të kontratës. Ata kanë bërë një kërkesë për demobilizim pavarësisht nëse ajo është bërë me apo pa dëshirën e tyre. Tani janë masat që duhet të respektohen dhe parashihet që nga 1 deri në 6 muaj pjesëtarët duhet të presin derisa t'u miratohet kërkesa e njëanshme për largim. Pra, në këtë rast pritet aprovimi i kërkesës nga ana ime. Por, prej momentit që pjesëtarët e FSK-së kanë kërkuar demobilizim, shkëputje të kontratës, derisa të marrin përgjigje janë të obliguar që të lajmërohen në punë. Nëse dy ditë nuk lajmërohen në punë, bazuar në ligj, fillon masa tjetër disiplinore, mblidhet bordi dhe merr vendim për largim.

**"Epoka e re":** *Këta pjesëtarë që kanë kërkuar dorëheqjen, a po dalin në punë?*

**Rama:** 29 prej tyre të hënën kanë qenë në punë në mëngjes. Tash kanë disa obligime të tjera që, nëse veç kanë vendosur të largohen, duhet t'i kthejnë pajisjet individuale apo kolektive. Aktualisht jemi në proces dhe procedurë. Nuk ka lëshim pe në kuptimin e thyerjes së rregullave dhe disiplinës. Të gjithë ata që nuk dëshirojnë të jenë pjesë e FSK-së do t'u shkëputet kontrata bazuar në kodin disiplinor. Në FSK të gjithë janë të barabartë dhe do t'u nënshtrohen rregulloreve dhe kodit disiplinor.

**"Epoka e re":** *A ka rrezik që në ditët në vijim të rritet numri i dorëheqjeve të pjesëtarëve serbë?*

**Rama:** Tash është më shumë çështje personale. Ata që mund t'u bëjnë ballë presioneve do të vazhdojnë të jenë pjesë e FSK-së, mirëpo nuk e kemi problem sepse kemi të interesuar të tjerë dhe shumë shpejt do ta plotësojmë numrin e të dorëhequrve.

**"Epoka e re":** *Do të jetë i lehtë procesi i zëvendësimit të tyre?*

**Rama:** Ka interesim të komunitetit serb për t'u bërë pjesë e

# ndikon në transformimin e FSK-së



FSK-së. Kemi edhe aplikues të tjerë. Do ta plotësojmë këtë numër pa asnjë problem. FSK-ja do të funksionojë me apo pa ata, me apo pa mua. FSK-ja nuk është organizatë që për 20-30 persona shuhet. FSK-ja do ta vazhdojë punën e vet.

**"Epoka e re":** *Në një farë mënyre a ka shkuar huq investimi në këta pjesëtarë?*
**Rama:** Jo, nuk ka shkuar. Ata i kanë kryer të gjitha obligimet që i kanë pasur. FSK-ja është organizatë vullnetare. Natyrisht se nuk është e mirë shkëputja e njëanshme e kontratës sepse do të ndikojë në jetën e tyre. Unë kam biseduar me shumicën prej tyre dhe 80 për qind kanë thënë se vendimin për largim e kanë marrë jashtë vullnetit të tyre. Ata kanë kryer obligimet për aq sa kanë shërbyer. Ata kanë shërbyer mirë, kanë qenë shumë të integruar dhe nuk kemi pasur asnjë problem.

**"Epoka e re":** *Për këtë shqetësim keni kërkuar ndihmë nga politika, përkatësisht nga drejtuesit e shtetit?*
**Rama:** Kemi biseduar me drejtuesit e shtetit dhe të gjithë janë të informuar për këto zhvillime. Po ashtu, kemi biseduar dhe janë të informuar edhe partnerët tanë. Ne e kemi ekipin këshillues të NATO-s, i cili është i njoftuar me procesin dhe raportet kanë shkuar edhe në nivelet më të larta.

**"Epoka e re":** *Keni kërkuar nga partnerët t'i bëjnë presion Serbisë për t'i ndalë kërcënimet dhe presionin mbi pjesëtarët serbë të FSK-së?*
**Rama:** Që dy muaj në vazhdimësi i kemi njoftuar për situatën dhe për kërcënimet e ndryshme, qoftë ato me bomba apo për ndalesat që u janë bërë pjesëtarëve gjatë kalimit në kufi me Serbinë. Të njoftuar kanë qenë KFOR-i, NATO-ja si dhe të gjitha ambasadat.

**"Epoka e re":** *Gjeneral, a do të ndikojnë këto largime në procesin e transformimit të FSK-së?*
**Rama:** Jo, nuk do të ndikojnë. Ky është një proces krejtësisht i ndarë. Jemi duke i kryer obligimet dhe punët tona. Ne e kemi bërë më të mirën të mundshme duke qenë institucioni shembull në vend, por edhe për shumë vende të rajonit jemi lider sa i përket përqindjes së komuniteteve në FSK. FSK-ja do të vazhdojë të jetë gjithëpërfshirëse, kredibile si dhe është e gatshme ta kryejë misionin e vet. Prandaj nuk shoh se këto largime do të kenë ndonjë ndikim në tranzicionin e FSK-së. FSK-ja është organizatë e gjallë, në kuptimin që ka lëvizje, pra çdo ditë dhe çdo vit shkojnë njerëz dhe vijnë njerëz të rinj. Në këtë drejtim nuk ka asnjë shqetësim. Nuk ka hapësirë për frikë sepse ne nuk i kemi larguar, por është largim i secilit me dëshirë. FSK-ja është organizatë vullnetare. Nuk kemi ushtri obliguese. Të gjithë ata që i plotësojnë kriteret mund të jenë pjesë e FSK-së. Nuk kemi pasur asnjë problem me këta që kanë kërkuar dorëheqje. Pa vullnetin e tyre po e bëjnë një hap të tillë, por është zgjedhja e tyre personale dhe ne nuk mund ta ndalim askënd me zor, sepse ky është shërbim vullnetar. E mira do të ishte që ata të kthehen sepse kemi një kontratë të përbashkët dhe nuk është etike që kontrata të shkëputet njëanshëm. Megjithatë, është çështje dhe zgjedhje e tyre individuale. Të gjitha të arriturat e deritanishme të FSK-së janë bërë në bashkëpunim me partnerët tanë dhe pa përkrahjen e tyre nuk do të ishim këtu ku jemi. Ne do ta vazhdojmë punën tonë pavarësisht prej këtyre rasteve individuale. Më vjen keq për këta pjesëtarë të FSK-së dhe për familjet e tyre, të cilët kanë marrë një vendim të gabuar por, si duket, kanë pasur presion. E kuptoj gjendjen e tyre.

# Thaçi: Largimi i serbëve nga FSK-ja është i organizuar

PRISHTINË, 9 KORRIK - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se po zhvillohen bisedime me disa pjesëtarë serbë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) për kthimin e tyre në këtë forcë, duke nënvizuar se askush nuk do të mund ta pengojë formimin e Forcave të Armatosura të Kosovës. Deklaratat e tij vijnë pas largimit të disa pjesëtarëve serbë të Forcës së Sigurisë së Kosovës nga kjo forcë pas presioneve të Beogradit.
Në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë", presidenti Thaçi ka theksuar se Kosova insiston në paqe dhe raporte të mira fqinjësore. "Është koha për dorështrëngim, jo për t'u shikuar përmes tytave", u shpreh Thaçi. Ai ka potencuar se Forca e Sigurisë së Kosovës është në rrugën e transformimit në ushtrinë e ardhshme të Kosovës. "Forcat e Armatosura të Kosovës do të jenë ushtri shumetnike, me standarde të NATO-s, gjithëpërfshirëse, në shërbim të paqes dhe stabilitetit. Do të jetë një ushtri me qëllim e vizion të sigurt për anëtarësim në NATO. Do të jetë një ushtri mbrojtëse, me synimin për pjesëmarrje në misione paqësore ndërkombëtare. Ajo paraqet mesazhin e paqes, në asnjë rrethanë kërcënim për askënd", ka deklaruar Thaçi.
Disa pjesëtarë serbë të FSK-së nga rajoni i Gjilanit javën e kaluar kanë paraqitur kërkesë për largim nga kjo Forcë për shkak të, siç është thënë, kërcënimeve dhe presioneve nga Beogradi. Kohët e fundit ata janë përballur me situata të pakëndshme, sulme me koktej molotovi ndaj pasurisë së tyre, ndalim gjatë kalimit kufitar në Serbi si dhe janë kërcënuar nga disa zyrtarë në Beograd për dënimin e tyre deri në 10 vjet burgim për shkak të pjesëmarrjes së tyre në "formacionet e huaja të armatosura" (FSK).
Presidenti Thaçi ka thënë se Forcat e Sigurisë së Kosovës po zhvillojnë konsultime, biseda të brendshme me pjesëtarët serbë të FSK-së rreth këtyre zhvillimeve, duke potencuar se askush nuk do të mund ta ndalë transformimin e kësaj force në ushtrinë e Kosovës. "Shihet se është një synim i organizuar. Tash për tash nuk mund të them se ka motiv të qartë politik, por autoritetet dhe zyrtarët, eprorët e lartë të FSK-së, janë duke i dëgjuar opinionet e secilit veç e veç, me mirëkuptimin më të madh që ata të vazhdojnë punën, ta luajnë rolin e vet që u takon për vendin e vet. Tekefundit, Kosova është atdhe i të gjithë qytetarëve të vet. Por, një gjë mund ta them, askush as në Kosovë e as jashtë Kosovës nuk mund ta frenojë të drejtën e Kosovës si vend i pavarur e sovran që ta ketë ushtrinë e vet. Kjo punë tanimë është e kryer", u shpreh presidenti Thaçi.



Ndërsa presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka deklaruar të dielën se qëndrimi i tij është që serbët e Kosovës nuk duhet të marrin pjesë në Forcat e Armatosura të Kosovës. "Nuk do të dëshironim që serbi të shtinte në serbin. Për çka tjetër do të shërbente kjo ushtri?!", ka ironizuar Vuçiqi, duke shtuar se kjo ushtri (e Kosovës) nuk do ta sulmonte Shqipërinë, shqiptarët në Maqedoni apo ata në Mal të Zi. Duke potencuar se një ushtri e Kosovës mund të shihet vetëm kundër serbëve dhe Serbisë, Vuçiqi ka deklaruar se nuk mund të shihet si presion kundërshtimi i Beogradit që serbët të jenë pjesë e FSK-së. "A do t'i lejojmë ata të na e vrasin popullin e ne të heshtim e ta shikojmë qiellin?", ka thënë Vuçiqi, duke përsëritur se veprimet, sipas tij, "kriminale kundër popullit serb, nuk do të përsëriten më".
Ndërkaq Thaçi ka thënë se Kosova nuk flet përmes armëve, por angazhohet për paqe, pajtim dhe raporte të mira me fqinjët. "Nuk dua t'i komentoj deklaratat që flasin për gjakderdhje, luftë apo shënjestrim të njëri-tjetrit. Koha është për shtrirjen e dorës së pajtimit, jo të shikimit përmes tytës", ka thënë Thaçi. Ai ka përsëritur se pret marrëveshje me Serbinë në dialogun e Brukselit, e cila do t'u ndihmonte të dy vendeve. Në çdo rrethanë, ka thënë Thaçi, e ardhmja e Kosovës nuk është e lidhur me atë të Serbisë. "Është shumë me rëndësi se, derisa të mbërrijmë deri te ky çast, duhet të sillemi në mënyrë korrekte me njëri-tjetrin, në mënyrë paqësore, me hapa përparimtarë dhe mirëkuptues ndaj njëri-tjetrit si dy shtete dhe si dy popuj", është shprehur Thaçi. Sipas tij, është me rëndësi që të dy shtetet të mos e befasojnë njëri-tjetrin. "Çdo pretendim për veto për themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës do të jetë i dështuar", ka theksuar presidenti Thaçi. Ai ka bërë të qartë se Kosova do t'i themelojë Forcat e Armatosura në partneritet dhe koordinim me NATO-n, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me partnerët e tjerë ndërkombëtarë.

## Kuvendi i Kosovës bëhet anëtar i Asamblesë së Frankofonisë




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 KORRIK - Kuvendi i Republikës së Kosovës është pranuar në Asamblenë Parlamentare të Frankofonisë, në mbledhjen e cila është mbajtur të hënën në Kanada. Lajmin e ka bërë me dije kryeparlamentari Kadri Veseli gjatë seancës së djeshme të Kuvendit. "Kam kënaqësinë e madhe t'ju njoftoj se Kuvendi i Kosovës është votuar që të anëtarësohet në Asamblenë Parlamentare të Frankofonisë. Unë jam i gëzuar që, pas shumë përpjekjesh, kjo nismë për t'u bërë pjesë e këtij institucioni të rëndësishëm ndërkombëtar të parlamentarizmit u kurorëzua me sukses. Kjo është organizata më e madhe ndërkombëtare parlamentare ku ne bëjmë pjesë dhe ofron një mundësi të jashtëzakonshme për diplomaci parlamentare", është shprehur Veseli. Ai ka shtuar se nëpërmjet këtij anëtarësimi forcohet subjektiviteti ndërkombëtar i shtetit tonë. "Do ta kemi mundësinë ta promovojmë Kosovën dhe të ndërtojmë marrëdhënie me parlamentarë të vendeve që ende nuk na njohin", ka thënë Veseli.
Anëtarësimi i Kuvendit të Kosovës në Frankofoni është nismë e kryeparlamentarit Kadri Veseli i cili muaj më parë ka takuar edhe krerët e kësaj asambleje, ndërsa ka zhvilluar edhe takime të ndryshme gjatë vizitave zyrtare në vende të ndryshme. Para një muaji, pikërisht për këtë çështje, kryeparlamentari Veseli ka pritur në Prishtinë sekretarin e përgjithshëm të Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë, Jacques Krabal.

## Pacolli në Samitin e Londrës flet për rëndësinë e bashkëpunimit të rinisë

LONDËR, 9 KORRIK - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, i cili po merr pjesë në samitin e radhës të "Procesit të Berlinit" në Londër, ka folur për rëndësinë e bashkëpunimit të rinisë dhe përmirësimin e perspektivës së tyre. Në pjesën fillestare të takimit të ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve të Ballkanit Perëndimor, Pacolli ka marrë pjesë në panelin diskutues me shoqërinë civile, ku është diskutuar lidhur me përmirësimin e perspektivës së rinisë në vendet e Ballkanit Perëndimor.
Në adresimin e tij ndaj pyetjeve të drejtuara nga përfaqësues të organizatave të ndryshme rinore nga Ballkani Perëndimor, ministri Pacolli ka theksuar rëndësinë e forcimit të rinisë në vetvete dhe rëndësinë e bashkëpunimit të rinisë me institucionet qeveritare për adresimin e shqetësimeve të tyre drejt përmirësimit të perspektivës përmes krijimit të kushteve më të mira për edukim, punësim etj.
Zëvendëskryeministri Pacolli gjithashtu ka shprehur kënaqësinë e tij për dinamikën pozitive të rinisë së Kosovës dhe për kontributin e saj për ndërtimin e vendit dhe të lidhjeve të mëtutjeshme me njerëzit e rajonit dhe më gjerë. "Përmes kreativitetit rinia e Kosovës duhet të vazhdojë ta ndjekë rrugën dinamike dhe ta mbajë gjallë shpresën dhe guximin për ndryshime pozitive. Ardhmëria është e saj", ka thënë Pacolli.



Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të hënën seancën plenare

# Mungojnë deputetët, shtyhet votimi i Projektligjit të Gjykatës së AKP-së

Deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk kanë arritur të hënën ta miratojnë Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për shkak të mungesës së deputetëve në procesin e votimit. Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, duke prezantuar para deputetëve Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me AKP-në, ka thënë se çdo vonesë për miratimin e këtyre ndryshimeve ka efekt drejtpërdrejt edhe në ekonominë e vendit tonë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 KORRIK - Edhe pse në sallë ishin 76 deputetë, vetëm 54 prej tyre kanë marrë pjesë në votimin e Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP). Kryesuesi i seancës, Xhavit Haliti, ka thënë se votimi i këtij projektligji shtyhet për seancën tjetër. Prej 54 deputetëve që kanë votuar, 36 ishin për, 18 kundër, asnjë s;ka abstenuar.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, duke prezantuar para deputetëve Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ka thënë se çdo vonesë për miratimin e këtyre ndryshimeve ka efekt drejtpërdrejt në ekonominë e vendit tonë. Tahiri ka thënë se si pasojë e ndryshimeve të mandatit të EULEX-it në gjyqësor, të cilat kanë hyrë në fuqi më 14 qershor të këtij viti, ndryshimi i këtij projektligji është esencial. "Duke qenë se gjyqtarëve ndërkombëtarë u ka përfunduar mandati, ndryshimet në strukturën që i parasheh ky ligj janë të domosdoshme për ta garantuar vazhdimësinë e punës pas largimit të gjyqtarëve ndërkombëtarë. Theksoj se për shkak të kompetencës ekskluzive të kësaj gjykate në çështjet që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, puna e kësaj gjykate ndikon drejtpërdrejt në dinamikën e procesit të privatizimit, si dhe bartja e mjeteve të mbetura në buxhetin e Kosovës, rrjedhimisht çdo vonesë në miratimin e këtyre ndryshimeve, ka efekt në ekonominë e vendit tonë", ka thënë Tahiri. Sipas tij, ky projektligj është një dëshmi konkrete se institucionet e Kosovës kanë kapacitet për ta udhëhequr vetë punën në këtë gjykatë. Ai ka thënë se janë rreth 21 300 lëndë të regjistruara që mbajnë peng qindra miliona euro, para këto që punëtorëve u takojnë nga 20 përqindëshi. Sipas tij, gjyqtarët dhe prokurorët do t'i kenë rreth 300 bashkëpunëtorë profesionalë.

Po në këtë seancë, në mungesë të votave, nuk ka kaluar propozimi i kryesisë së Kuvendit të Kosovës për rregull të ri sa i përket votimit dhe pauzës së deputetëve. Ky rregull parashihte që seancat të fillojnë në orën 10:00, ndërsa në orën 14:30 deputetët do të duhej të ktheheshin nga pauza e drekës. Po sipas këtij rregulli, votimi i çështjeve të diskutuara duhej të bëhej në orën 17:00. Për këtë çështje kanë votuar për 50 deputetë, kurse 10 kanë abstenuar. Për t'u bërë i plotfuqishëm ky rregull është dashur të votojnë 80 deputetë.

Në këtë seancë, pos të tjerash, pozita dhe opozita janë ballafaquar për tema të ndryshme. Fillimisht deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje!, Albulena Haxhiu, ka thënë se është e qartë se Kosova është duke u qeverisur nga një koalicion i pakicës. Ajo ka thënë se pozita duhet ta kuptojë se është pakicë dhe nuk mund ta hedhë fajin tek opozita. I menjëhershëm ka qenë reagimi i kryeparlamentarit Kadri Veseli, i cili ka thënë se opozita nuk ka guxim të ngrehë votëbesim për rrëzimin e Qeverisë.



# Hoti: Koalicioni qeverisës nuk ka legjitimitet për të vazhduar më tutje



PRISHTINË, 9 KORRIK - Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, e ka përsëritur edhe të hënën qëndrimin se duhet të shkohet në zgjedhje të reja pasi që, sipas tij, Qeveria nuk ka numra e unitet. "Sot ishte seanca e Kuvendit në të cilën ishte për shqyrtim Ligji për Dhomën e Veçantë për Gjykatën Supreme. Normalisht se nuk ka kuorum në sallë, sepse kjo shumicë është e shpartalluar. Është për keqardhje që javën që shkoi për zgjedhjen e gjyqtarëve u bënë 100 veta në sallë, ndërkohë që për punë të rregullta asnjëherë nuk bëhet shumica. Kjo Qeveri sa më parë duhet të shkojë dhe të krijohen institucionet legjitime. Kjo është prova më e mirë që koalicioni qeverisës nuk ka legjitimitet për të vazhduar më tutje", ka thënë Hoti. Ai ka shtuar se Isa Mustafa në takim me kryeministrin Haradinaj e ka bërë të qartë qëndrimin e LDK-së lidhur me dialogun me Serbinë. "Mustafa ua ka bërë të qartë qëndrimin e LDK-së sa i përket dialogut me Serbinë. Në parim LDK-ja qëndron si parti për dialog, sepse është e vetmja mënyrë, por dialogu duhet të zhvillohet nga institucionet që janë legjitime. Për momentin nuk ka institucione legjitime që mund të udhëheqin procese të rëndësishme", ka thënë Hoti.

# Punëtorët e Postës së Kosovës ndërpresin grevën

**Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka bërë me dije se kanë gjetur një zgjidhje për pagesën e Telekomit për qiranë e Postës dhe kanë filluar të shpërndahen pagat dhe greva ka përfunduar. "Telekomi është në krizë financiare mjaft serioze, prandaj ka pasur vështirësi edhe për pagesat me kohë ndaj Postës së Kosovës", ka thënë Lluka**



Bujar Tërstena (REE/RL)

Prishtinë, 9 korrik (ER) - Punëtorët e Postës së Kosovës kanë ndërprerë grevën pas arritjes së një marrëveshjeje me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik. Greva e punëtorëve të Postës kishte nisur të hënën në orën 8:00 të mëngjesit dhe ishte paraparë të jetë njëditore. Arsyeja e grevës ishte për shkak se punëtorët nuk kanë marrë pagat për këtë muaj.

Në një konferencë për media ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka bërë me dije se ka filluar shpërndarja e pagave për punëtorët dhe se greva është ndërprerë. "Me ndërmjetësim të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik e kemi gjetur një zgjidhje për pagesën e Telekomit për qiranë e Postës dhe kanë filluar të shpërndahen pagat dhe greva ka përfunduar. Kjo është një arritje e përkohshme. Telekomi është në krizë financiare mjaft serioze dhe si rezultat ka pasur vështirësi edhe në pagesat me kohë ndaj Postës së Kosovës. Në anën tjetër, Posta e Kosovës të hyrat kryesore i ka nga qiraja që i merr nga Telekomi", ka thënë Lluka.

Ndryshe, Posta e Kosovës ka operuar në sistemin e Postës dhe Telekomit të Kosovës. Por, në vitin 2012, me vendim të Qeverisë, Posta është ndarë nga Telekomi dhe është themeluar si ndërmarrje publike qendrore. Posta e Kosovës dy herë i është nënshtruar procesit të privatizimit, por dy herë radhazi Qeveria e Kosovës ka dështuar ta përmbyllë me sukses këtë proces.

# Fondi Kosovar për Garanci Kreditore bëhet anëtar i AECM-së

**Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) është bërë anëtar i Shoqatës Evropiane për Institucionet Garantuese (AECM). AECM-ja është një shoqatë ndërkombëtare jofitimprurëse me bazë në Bruksel, e cila funksionon si organizatë e hapur, demokratike, e pavarur nga çdo grup politik apo financiar**

FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

EPOKA E RE A. MAVRAJ

Prishtinë, 9 korrik - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) ka arritur të bëhet anëtar i Shoqatës Evropiane për Institucionet Garantuese (AECM). Bordi i AECM-së së bashku me asamblenë e përgjithshme zyrtarisht e pranuan kërkesën e FKGK-së për anëtarësim në mbledhjen vjetore të mbajtur më 14 qershor të këtij viti. AECM-ja është një shoqatë ndërkombëtare jofitimprurëse me bazë në Bruksel, e cila funksionon si organizatë e hapur, demokratike, e pavarur nga çdo grup politik apo financiar. AECM-ja aktualisht ka 47 organizata anëtare që veprojnë në Bashkim Evropian, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Serbi, Rusi dhe Turqi.

Anëtarët e saj janë institucione garantuese private, publike dhe të kombinuara, si dhe banka zhvillimore me divizion specifik për garanci. Të gjithë kanë mision të përbashkët, t'i garantojnë kreditë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që kanë një projekt të shëndoshë ekonomikisht, por që nuk mund të sigurojnë kolateral të mjaftueshëm bankar. "AECM-ja shërben si një platformë e shkëmbimit të përvojave më të mira në çështje të ndryshme operacionale, si dhe ofron informata të ndryshme nga hulumtimet që bëhen lidhur me sektorin garantues. Të gjitha këto do të mundësojnë që FKGK-ja të përfitojë nga anëtarësimi në AECM në saje të shkëmbimit të përvojave me institucione garantuese me përvojë të gjatë, gjithnjë me qëllim të arritjes së objektivave të saj si përkrahja e sektorit privat në Kosovë, zgjerimi i qasjes në financa për ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe të mëdha, krijimi i vendeve të punës, rritja e prodhimit vendor, përmirësimi i bilancit tregtar si dhe avancimi i mundësive për sektorët ekonomikë më pak të shërbyer", është thënë në njoftimin për medie të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.

Në vitin 2017 bilanci i portofolit të garantuar të anëtarëve të AECM-së ishte mbi 125.6 miliardë euro, ndërsa vlera e garancive të reja ishte mbi 74.2 miliardë euro.

## MPMS-ja e GIZ-i ofrojnë mundësi punësimi për 400 punëkërkues nga Kosova



Prishtinë, 9 korrik - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), së bashku me GIZ-in gjerman, kanë lansuar të hënën skemën "Praktikë në punë", nga e cila do të përfitojnë mbi 400 punëkërkues të regjistruar. Koha e aplikimit është e hapur nga data 9 korrik deri më 17 gusht. "Punëkërkuesit e regjistruar pranë Zyrave Komunale të Punësimit, të rinjtë e moshave 18-35 vjeç, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të riatdhesuarit dhe minoritetet e të gjitha moshave, kanë të drejtë të aplikojnë në këtë skemë. Praktika zgjatë gjashtë muaj dhe pagesa është 150 euro në muaj. Në skemën 'Praktikë në punë' kanë të drejtë të aplikojnë punëdhënësit-kompanitë të cilët kanë nevojë për praktikantë dhe që kanë aplikuar dhe regjistruar vendet e lira të punës pranë Zyrave të Punësimit në komunat e tyre. Koha e aplikimit është e hapur nga data 9 korrik deri më 17 gusht 2018", është bërë me dije në njoftimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

(A. SHEFKIU)

# Minatorët e 'Trepçës' hyjnë në grevë të përgjithshme



PRISHTINË, 9 KORRIK - Minatorët e Kombinatit "Trepça" në Kosovë kanë hyrë në grevë të përgjithshme, duke i fajësuar institucionet se nuk i kanë plotësuar kërkesat e tyre. Punëtorët kërkojnë që të gjitha vendburimet përreth "Trepçës" dhe të gjitha zonat e interesit të përfshihen në draft-statutin e kombinatit "Trepça". Ata, po ashtu, kërkojnë t'u njihet përvoja e punës, siguria shëndetësore në punë, si dhe pensioni të jetë 70 për qind i pagës.
Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Trepçës, Shyqri Sadiku, ka bërë me dije se minatorët i kanë dhënë afat Qeverisë që deri të hënën t'i plotësojnë kërkesat e tyre por, siç ka thënë ai, ata nuk kanë marrë asnjë përgjigje nga institucionet përkatëse. "Minatorët kanë marrë vendim që sot të hyjnë në grevë të përgjithshme. Greva do të vazhdojë, por nuk e di deri kur. Greva po mbahet në Stantërg. Gjithashtu, ka filluar greva edhe në Artanë (Novobërdë) dhe Kishnicë. E gjithë Trepça është në grevë, të gjitha njësitë", ka thënë Sadiku për "Radion Evropa e Lirë".
Minatorët e Trepçës muajin e kaluar kanë hyrë në grevë njëorëshe dhe kanë parashtruar kërkesat e tyre ndaj institucioneve.
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, më pas, ka kërkuar afat prej dy javësh për t'i shqyrtuar kërkesat e minatorëve. Por, sipas Shyqri Sadikut, ky afat ka skaduar më 9 korrik.

# Veseli pranon raportin e auditimit për OEK-un



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, pasi ka pranuar raportin e auditimit të Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) për vitin 2017, ka bërë thirrje për syçeltësi të shpenzimit të parasë publike, ndërsa punën e Odës Ekonomike e ka konsideruar shembull të punës për agjenci që i raportojnë Kuvendit

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 9 KORRIK - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të hënën në takim përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), nga të cilët ka pranuar raportin e auditimit për OEK-un për vitin 2017. Bazuar në të dhënat e raportit, kryeparlamentari Veseli e ka vlerësuar Odën Ekonomike shembull të punës transparente dhe të shpenzimit të parasë, e vlerësuar tashmë edhe nga auditorë evropianë.
Veseli ka thënë se Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Odën Ekonomike i lidhë vlerësimi i auditorëve për të dyja institucionet, duke i konsideruar kampionë të transparencës dhe të menaxhimit të buxhetit. "Kuvendi i Republikës së Kosovës po ashtu është kampion në auditime gjatë gjithë këtyre viteve, në vazhdimësi. Unë si kryetar i Kuvendit vetëm sa e kam thelluar transparencën dhe llogaridhënien para qytetarëve", është shprehur Veseli.
Kreu i Kuvendit ka bërë thirrje për syçeltësi të shpenzimit të parasë publike, ndërsa punën e Odës Ekonomike e ka konsideruar shembull të punës për agjenci që i raportojnë Kuvendit.
Ndërkaq kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka thënë se qëllimi pse i po dorëzohet Kuvendit ky raport, është edhe fakti se në tre vjetët e fundit Kuvendi, bazuar në të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm, ka qenë një ndër institucionet më transparente. Gërxhaliu ka theksuar se raporti i auditimit për OEK-un për vitin 2017, i realizuar nga një kompani prestigjioze evropiane, është pa asnjë të gjetur negative.

# 'Haxhi Zeka' do t'i regjistrojë 2 417 studentë

PEJË, 9 KORRIK (ER) - Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë ka shpallur konkursin për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore - baçelor në vitin akademik 2018/2019.
Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë në vitin e parë të studimeve, në afatin e parë të konkursit për vitin akademik 2018/2019, do t'i regjistrojë 2 417 studentë, prej të cilëve 1 927 studentë të rregullt dhe 490 studentë me korrespondencë.
Mbi numrin e përgjithshëm të studentëve të paraparë si më sipër, Universiteti do të regjistrojë deri në 2 % studentë të rregullt që i takojnë familjes së ngushtë të dëshmorëve (anëtarë të familjes së ngushtë të dëshmorëve janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët).
Studentët e kësaj kategorie do të shpërndahen në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin program të fakulteteve veç e veç.
Si shtesë e numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 të MAShT-it, Universiteti do të regjistrojë deri në 12 % studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë.
Kuota prej 12 % të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti joshumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin program të fakulteteve veç e veç.
Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MAShT-i, mund të pranohen edhe kandidatët nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvegja, Maqedonia dhe Shqipëria. Kandidatët të cilët kanë lindur në vendet e sipërshënuara, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë mbaruar në Republikën e Kosovës, do t'u nënshtrohen kushteve të njëjta për pranim si kandidatët nga Kosova.




Mbi bazë të konsideratave humane, Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë rezervon të drejtën e pranimit të kandidatëve me nevoja të veçanta.
Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve: Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës 9. 7. 2018 deri më 23. 7. 2018 nga ora 09:00 deri 15:00 (dokumentet do të pranohen çdo ditë, me përjashtim të ditës së diel).
Programet e studimit këtë vit janë: Fakulteti i Biznesit, Menaxhment në Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis, Fakulteti Juridik, Agrobiznes dhe Fakulteti i Arteve.

# Nënshkruhet memorandumi i bashkëpunimit për restaurimin e Mejtepe Ruzhdisë



GJAKOVË, 9 KORRIK (ER) - Komuna e Gjakovës, e përfaqësuar nga kryetari i saj, Ardian Gjini, ka nënshkruar të hënën një memorandum bashkëpunimi me organizatën turke "Tika" dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për restaurimin e objektit të Mejtepe Ruzhdisë, i cili dikur ka funksionuar si shkollë e ulët e Muzikës. "Gjakova po merr pamje dhe karakter tjetër për shkak se ky projekt do të jetë plotësisht i inkorporueshëm me planin tonë për Çarshinë e Vjetër dhe Lumin Krena. Do të jetë një projekt jo i fshehur nga sytë e publikut, por do të jetë plotësisht i ekspozuar ashtu siç duhet të jetë. Faleminderit 'Tikës' për investimet! Faleminderit ministrisë për mbështetje!", është shprehur kryetari Gjini gjatë aktit të nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit.
E përfaqësuesit e "Tikës" u shprehën se janë shumë të gëzuar që ndodhen në Gjakovë për një projekt shumë të vlefshëm. Në emër të Ministrisë së Kulturës, zëvendësministrja Burbuqe Bakija-Deva ka falënderuar "Tikën" për të gjitha investimet që po bënë në Kosovë, veçanërisht në fushën e trashëgimisë kulturore.
Bashkëpunimet e Komunës së Gjakovës dhe Tikës do të finalizohen së shpejti edhe me përfundimin e punimeve për renovimin dhe furnizimin me mobilie të Konviktit të Studentëve "Sadik Stavileci".

## Kërkohet realizimi i vendimit për shitësit e pjeprave në Mitrovicë



MITROVICË, 9 KORRIK (ER) - Është mbajtur mbledhja e rregullt javore e kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, me drejtorët e drejtorive komunale, në të cilën janë diskutuar disa pika të rëndësishme që kanë të bëjnë me drejtoritë komunale.
Drejtori i Drejtorisë së Financave, Shukri Gashi, ka kërkuar nga drejtorët e tjerë t'i barazojnë faturat e shpenzimeve para se të përgatitet raporti financiar gjashtëmujor. Ai në vazhdim i ka njoftuar pjesëmarrësit në mbledhje për takimin në të cilën është folur për procesin e buxhetit për vitin 2019-2021, ku si konkluzion ka dalë edhe vlerësimi i transparencës nëpër komuna, me ç'rast ato të cilat janë më transparente, do të shpërblehen me financimin e projekteve të ndryshme.
Pikë tjetër e rendit të ditës ishte realizmi i vendimit të marrë më parë për zhvendosjen e shitësve të pjeprave në një hapësirë të posaçme afër xhamisë.
Kryetari Bahtiri ka kërkuar urgjentisht të kryhen të gjitha procedurat e nevojshme dhe ky vendim të realizohet sa më shpejt.

## Lekaj e Suma nënshkruan memorandum bashkëpunimi

HANI I ELEZIT, 9 KORRIK (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka pritur të hënën në takim kryetarin e Hanit të Elezit, Rufki Suma, me të cilin kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi për realizimin e një projekti me rëndësi për banorët e kësaj komune. Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Hanit të Elezit ka të bëjë me realizimin e projektit të rrugës Dermjak - Nesalc, ndërsa vlera e realizimit të këtij projekti kap shumë prej 450 mijë eurosh.
Ministri Lekaj dhe kryetari Suma, iseduan edhe për një sërë projektesh infrastrukturore për Hanin e Elezit, e të cilat kërkojnë vëmendjen e Ministrisë së Infrastrukturës, ku ministri Lekaj i premtoi kryetarit Suma, se brenda mundësive buxhetore dhe ligjore kjo komunë do të përkrahet në projektet e saj infrastrukturore.



# PROBLEME THEMELORE TË PUNIMEVE STUDIMORE (5)



Hajdin ABAZI

### 8. Metodologjia nuk është formalitet, por tregues se si do të bëhet shkencë

Të artikulohet metodologjia nuk është tepër e vështirë e aspak nuk është e pamundur. Përkundrazi, mund të bëhet nga secili studiues, por që të bëhet - paraprakisht kërkohet të jesh i ndërgjegjshëm se si duhet bërë shkencë.
Lypset që vetë studiuesi të jetë i bindur dhe ta ketë kuptuar drejt rëndësinë shkencore që ka metodologjia, jo vetëm si pjesë që duhet shkruar diku në një nënkapitull në "hyrje", por, mbi të gjitha,që të zbatohet në mënyrë konsekuente përgjatë tërë studimit. Kur kjo të bëhet, atëherë është kuptuar mënyra bashkëkohore e bërjes shkencë. Në këtë aspekt, nuk ka studim të mirëfilltë shkencor pa një metodologji të shtruar qartë, të përcaktuar saktësisht dhe që është ndjekur për të realizuar studimin.
Kam bindjen e mbështetur, në përvojën time por edhe në disa studime të tjera, se me pak përkushtim mund të formulohet në mënyrë korrekte metodologjia dhe të zbatohet pastaj në studime. Nuk them se është e lehtë, sikurse që nuk është e lehtë të bësh shkencë, por them se, me punë e ushtrime, është arritshme. E për këtë, nevojitet insistimi i mentorëve si udhëheqës shkencorë, por edhe shpjegimi i qartë prej tyre se si mund të bëhet kjo. Shpesh metodologjia përcaktohet shumë qartë në projekte hulumtimi, gjë që është tregues se edhe në punimet studimore (temë masteri, temë doktorate apo monografi) është po aq e mundur.

### 9. Përgjatë tërë studimit duhet ndjekur me konsekuencë metodologjia

Përcaktimi i qartë i metodologjisë duhet të jetë ashtu që të kihet parasysh përgjatë tërë studimit, domethënë studimi të udhëhiqet prej fillimit deri te përfundimi sipas metodologjisë së përcaktuar, për të qenë konsekuent në qasje.
Gabimet e rëndomta janë dy llojesh.
Në njërën anë metodat dhe teknikat e përmendura në "hyrje" zakonisht harrohen dhe nuk përdoren. Gjetjet dhe rezultatet shpesh ndodhë të arrihen në mënyrë të paqartë.
Në anën tjetër, metodologjia, përkatësisht përshkrimi se si do të përdoren metodat dhe se si konkretisht do të bëhet realizimi i punimit, zakonisht harrohet dhe ka jo konsekuencë e shmangie nga ajo përgjatë realizimit të studimit dhe nxjerrjes së përfundimeve.
Ndodhë e njëjta gjë si me objektivat, pyetjet studimore dhe hipotezat: harrohet metodologjia. Pikërisht kjo "harresë" shpërfaq atë se si perceptohet realizimi i një punimi studimor: nuk ka rëndësi se çfarë thua për metodologjinë, konkretisht për metodat dhe se si këto do të përdoren në realizimin e studimit, thjesht vazhdo, shkruaj, mbush faqe, disa kapituj, mbërrij në "përmbyllje" dhe jep ca "rekomandime" dhe - puna u krye. Po, puna u krye, por si?
Një metodolog i mirëfilltë do të mund të gjente aq shumë shkarje, s'përputhje, shpërfillje, veprime krejt në kundërshtim me atë që është përcaktuar si metodologji sepse nuk është zbatuar ajo gjatë studimit. Domethënë, mbetet e paqartë se ku përdoret njëra metodë e ku tjetra apo se si përdoren ato.
Diçka e këtillë mund t'i shkojë një shkrimi me karakter jo shkencor, por jo një studimi që pretendon dhe pohon se është shkencor.

### 10. Transparenca metodologjike e bën shkencën të hapur e publike

Metodologjia, pra, duhet të jetë dhe është një standard themelor për realizimin e studimit, që duhet të kihet vazhdimisht parasysh, të kihet në mendje dhe të zbatohet në secilin hap të studimit.
Ajo të tregon se si do të bëhet studimi, dhe në të njëjtën kohë edhe shërben si kontrollues se a është bërë ashtu studimi apo jo. Kjo domethënë se përgjatë realizimit të studimit, metodologjia mund të ndryshojë, të kalibrohet, të korrektohet, përplotësohet ashtu që të harmonizohet me natyrën e studimit. Kur formulohet metodologjia, në fazat deri te përpunimi final, përcakton ravijëzimin themelor por gjatë studimit mund të shfaqen (në fakt të hetohen me vonesë) edhe nevoja të tjera (për shembull, ndonjë metodë, ndonjë teknikë, ndonjë instrument etj.) e që duhet të inkorporohen, të ndërthuren dhe të plotësohen.
Kur të realizohet studimi dhe të paraqitet në fazën finale, i gatshëm për publikim apo mbrojtje, atëherë metodologjia duhet të jetë e plotë, dhe të tregojë se studimi njëmend është realizuar ashtu sikurse është pohuar se do të realizohet, dhe se duke ndjekur atë metodologji është mbërritur rezultati i studimit.
Pikërisht metodologjia, domethënë artikulimi i qartë i metodave dhe se si janë përdorë ato, me ndjekjen në mënyrë konsekuente e bënë shkencën transparente në arritjen e rezultateve, në një mënyrë të tillë që kushdo që është i interesuar mundet ta kontrollojë korrektësinë e arritjeve të studimit duke ndjekur të njëjtën metodologji. Me fjalë të tjera, shkenca e tregon saktë, kuptueshëm dhe qartë, pra me cilat metoda dhe se si, mënyrën e realizimit të studimit.
Krejt në fund, duhet të ngulitet mirë në mendje se vetëm metodologjia është ajo që shkencën e bënë të hapur, publike, transparente dhe me rezultate që mund të kontrollohen. Kjo tregon rolin dhe rëndësinë e metodologjisë për një punim studimor që pretendon të jetë shkencor. Sugjerimi është se punimet studimore me karakter shkencor duhet t'i kushtojnë vëmendjen, përkushtimin dhe shqyrtimin e duhur aspektit metodologjik, raportin e tij me qëllimin, objektivat, pyetjet studimore dhe hipotezat. Duhet shtuar vazhdimisht kërkesat, por edhe të rritet ndërgjegjësimi mbi atë se nuk mund të bëhet shkencë mirëfilli pa kushtimin e vëmendjes së duhur për metodologjinë. Arritja e standardeve bashkëkohore të shkencës sa i përket metodologjisë duhet të vihet si një synim i universiteteve, ashtu që të nxitet ngritja e nivelit të bërjes shkencë dhe transparencës së plotë të rezultateve të arritura.

## III. DESKRIPTIVIZMI LËNDON KARAKTERIN STUDIMOR

Një problem tjetër, shumë serioz, është ai që ka të bëjë me mënyrën se si realizohen shumica e punimeve të ndryshme. Ka jo pak aspekte jo të duhura që lidhen me mënyrën e realizimit të punimeve, por këtu do të theksohet njëra që është e pranishme gjithandej dhe që thuaja është shndërruar në një patologji studimore. Kjo është mënyra deskriptive (përshkruese) e punimeve, për të cilën do të parashtroj ca mendime në vazhdim.

### 1. Deskriptivizmi, qasja përshkruese

Shumë punime studimore po qe se lexohen me vëmendja dhe po qe se kërkohet t'u vihet një emërues i përbashkët atëherë ai do të mund të ishte - deskriptivizëm. Një qasje e cila karakterizohet kryesisht si përshkruese.
Deskriptivizmi është një teknikë e cila përdoret thuaja në çdo studim, dhe është pjesë përbërëse e domosdoshme. Kjo, natyrisht, është e vërtetë dhe praktika e ka treguar si përdorim të dobishëm.
Përdorimi i këtillë, gjithsesi, nuk ka asgjë të keqe; madje është e kundërta, është mjaft ndihmues dhe, po qe se përdoret me korrektësi dhe në vendin e duhur, i shërben mirë studimit.
Si i këtillë, deskriptivizmi nuk është aspak shqetësues. Madje, ai rekomandohet dhe është domosdoshmërisht pjesë përbërëse e çdo studimi. Këtu nuk është fjala për deskriptivizmin si teknikë që e sugjeron edhe qasja metodologjike për t'u përdorur në rastet kur kjo është e nevojshme. Është fjala për një përdorim përtej kësaj.

### 2. Kur bëhet shqetësues deskriptivizmi?

Deskriptivizmi bëhet shqetësues, atëherë dhe vetëm atëherë kur ai bëhet dominues si qasje dhe si metodologji. Një punim i tërë, i shkruar kryesisht për tema të njohura dhe ku mbizotëron teknika përshkruese shndërrohet në një punim që e humb karakterin studimor.
Ky është rreziku që sjell me vete deskriptivizmi si qasje, po qe se përdoret përtej asaj që do të duhej, tejmasshëm pra, dhe duke e bërë dominuese në një punim që pretendon të jetë studimor dhe me karakter shkencor.
Ky është një teprim metodologjik, një ekskluzivitet, që kthehet pa dashje një patologji shkencore, që e zhvesh punimin nga karakteri i mirëfilltë studimor.
E pikërisht një qasje e këtillë, i dominuar nga fryma deskriptive, është ajo që e karakterizon një shumicë të punimeve studimore.

### 3. Deskriptivizmi si qasje themelore vlen vetëm në raste të rralla

Deskriptivizmi si metodologji themelore e një studimi ka kuptim vetëm në raste të veçanta. Zakonisht kjo ka të bëjë me ndonjë prurje të panjohur nga më parë, dhe e cila ka nevojë të përshkruhet, ashtu që të ndihmojë të krijohet një vizion apo imazh për atë që bëhet fjalë.
Të këtilla mund të jenë temat e reja, të pa trajtuar ndonjëherë dhe që do të ishin risi. Në raste të këtilla, po, deskriptivizmi është qasja më e preferuar, sepse duke e përshkruar atë, në njërën anë depërtohet më thellë dhe shprishet mjegulla që e mbulon atë, dhe në anën tjetër lehtësohet krijimi i një perceptimi te të tjerët.
Kështu ndihmohet krijimi i përfytyrimeve se si mund të jetë, se si mund të duket dhe se si manifestohet diçka që më parë as që është ditur për të.
Studimet e kësaj natyre janë tepër të rralla, përgjithësisht në historinë e shkencës.

### 4. Në temat e njohura pak vend ka për deskriptivizmin

Në punimet studimore që zakonisht realizohen nëpër universitetet tona nuk di se ka pasur ndonjë studim të këtillë tepër të veçantë, që të jetë e natyrshme dhe e pashmangshme qasja deskriptive, me qëllim që të bëhet e kuptueshme tema që shtjellohet.
Zakonisht në punime të këtilla trajtohen tema shumë të familjarizuara nga fusha të ndryshme, si politike, sociologjike, filozofike, etike, administrative, ekonomike, juridike etj. Përgjithësisht, temat e trajtuara janë të njohura, shpesh edhe të trajtuara më parë, ose për të cilat flitet edhe në opinionin publik.
Se trajtohen tema të këtilla, vetëm pse janë të njohura, nuk ka ndonjë të keqe. Mangësia e trajtimeve të tilla qëndron gjetiu, dhe pikërisht te qasja e tyre. Konkretisht te praktika që të përshkruhet ajo që, në fakt, është njohur. Deskriptivizmi i këtillë krijon stereotipa dhe e zbeh vlerën studimore deri në shpërfillje.

### 5. Asgjë e re

E keqja e qasjes thuaja ekskluzive deskriptive është se punimin e lë në nivelin e një transmetuesi të asaj që gjetiu dhe kaherë është e përshkruar qartë. Duke qenë i kufizuar nga kjo qasje, punimi nuk ka se si të sjellë kreativitet, ide, mendime ose ndonjë aspekt me vlerë studimore.
Në shumicën e rasteve, përshkrimi në punim nuk është as në nivelin e ligjeve apo statuteve të ndryshme, ku përshkruhen qartë strukturat, hierarkia, funksioni dhe veprimi. Duke mbetur në nivel deskriptivizmi punimet e tilla, prej të cilave përfitohen tituj shkencorë, i ngjajnë një kompilimi të asaj që gjendet gjetiu, si në ndonjë ligj, akt administrativ, rregullore, kod, statut etj.
Gjatë leximit nuk ndjehet asgjë e re, e panjohur, e pa ditur, madje shpesh ka shumë mangësi edhe në atë që synohet të përmblidhet.

### 6. Frenues i kreativitetit dhe risisë intelektuale

Duke lexuar pjesën e punimit që pason "hyrjen", për shkak të qasjes deskriptive, thuaja asgjëkund nuk ndjehet prania e autorit. Ai flet në mënyrë pavetore, jo se nuk ka çka të thotë, por sepse qasja e bllokon dhe nuk i lë fushëveprim shprehjes së tij/ saj. Thjesht, ai/ ajo përfol ato që i kanë thënë/shkruar të tjerët. Asgjë të veten nuk thotë, ani se ka shumë për të thënë dhe që do të mund të thuhej.
Kjo duket disi absurde. Dhe këtë do të përpiqem ta sqarojë se përse.
Përderisa te studimet e rralla e tepër të veçanta, metodologjia deskriptive është shumë tërheqëse, gjithandej ndjehet tek autori/autorja, sepse ai/ajo përshkruan dhe shpjegon, tregon dhe shpreh ato që ai i ka parë me "syrin e mendjes" e që neve, lexuesve, na bën t'i shohim me syrin tonë optik.
Në raste të tilla, deskriptivizmi është tërësisht kreativ dhe po aq inovative.
Por te studimet e këtilla sikurse bëhen zakonisht nëpër universitetet tona, si punime seminari, tema masteri e tema doktorate, duke mos qenë e duhur, qasja deskriptive shndërrohet në pengesë, në frenues dhe në mbytës të kreativitetit dhe inovativitetit intelektual, qoftë edhe në nivel minimal, që duhet të ketë një punim studimor. Gjatë leximit të një punimi të tillë, thuaja gjithçka është e njohur nga më parë dhe asgjë nuk është e tillë që të mos jetë ditur; madje shpesh ndjehet ngushtësia (reduktimi) e përshkrimit gjë që e bën punimin të lë shumë për të dëshiruar edhe në vetë deskriptivizmin e aplikuar.
**(Vijon)**

**(Autori është prof. ass. dr. dhe ka ligjëruar për shumë vite lëndët Shkrimi akademik dhe Metodologjia e hulumtimit shkencor)**

# Dialogu i pambaruar



Hysni GUCATI

Kaluan shumë vjet duke biseduar me Serbinë në dëm të Kosovës. Sigurisht pala ndërmjetësuese nuk po dëshiron ta mbajë anën e së drejtës, pra të Kosovës, e cila po dëmtohet skajshmërisht qëkur kanë filluar bisedimet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pjesë e këtyre bisedimeve kanë qenë decentralizimi dhe eksterritorialiteti i kishave dhe manastireve ortodokse, proces ky që e ka dëmtuar Kosovën në aspektin territorial dhe në atë politik. Decentralizimi do t'ia mundësojë Serbisë ushtrimin e kontrollit në më shumë se 15 % të territorit të Kosovës (prej rajonit të Anamoravës e deri në Graçanicë), pa llogaritur këtu edhe 17 % të territorit që shteti serb ka në veriun e Kosovës, ku funksionon çdo strukturë institucionale e këtij shteti. Procesi tjetër plotësues me atë të decentralizimit është eksterritorialiteti i objekteve fetare ortodokse. Sipas planeve të Qeverisë serbe, statusin eksterritorial do ta fitojnë dhjetëra kisha dhe manastire ortodokse, të cilat Serbia i quan të një 'rëndësie strategjike', hapësirë kjo që përfshin rreth 1.000 km2, apo mbi 9 % të territorit të Kosovës. (Eksterritorialiteti sot e ka kuptimin e krijimit të një minishteti brenda shtetit të Kosovës). Duke e biseduar këtë temë me shokë e miq, madje edhe me kolegët e mi të organizatës së veteranëve të UÇK-së, njerëzit jo që nuk pajtohen, por janë të gatshëm të dalin në mal, dikujt edhe mund t'i duket e çuditshme, por kjo ndodh. Shumë vjet para se UÇK-ja të formohet disa njerëz në shenjë pakënaqësie me pushtetin brutal të Milloshevigit dolën në mal e me kalimin e kohës e formuan edhe UÇK-në. Kam dëgjuar njerëz në tubime, ndeja e oda duke biseduar mes vete se "cili është kuptimi i dialogut". Njerëzit ndoshta nuk e dinë se sa e kanë dëmtuar 33 marrëveshjet e arritura gjatë dialogut (bisedimeve) Kosovë - Serbi, Kosovën. Madje shumëkush nuk e di sa prej tyre janë zbatuar gjerë më sot e sa nuk janë zbatuar. Lidhur me dialogun është edhe diçka tjetër që të bën të mos ndihesh mirë, gjatë gjithë procesit të bisedimeve është vërejtur një mungesë e transparencës dhe kjo tregon se palët kanë fshehur shumëçka nga ky proces që shkon në dëm të palës së Kosovës.

Njerëzit pak apo aspak po e përmendin kompromisin rreth fusnotës e cila, po ashtu, ka qenë ndër vendimet e dhimbshme (lëshim pe apo vendim i papërgjegjshëm) që e ka dëmtuar pavarësinë dhe shtetësinë e Kosovës. I gjithë ky proces i dëmshëm ndodhi kinse në emër të përfaqësimit rajonal të Kosovës, për ta forcuar Kosova perspektivën e vet evropiane, gjë që nuk ka ndodhur deri më tani diçka e tillë.

Ky ishte një mashtrim klasik i popullit të Kosovës nga përfaqësuesit e zgjedhur të saj. Kjo ishte marrëveshja që Kosova heqë dorë nga shtetësia e saj dhe e kthej Kosovën dekada pas.

Shumica prej këtyre marrëveshjeve edhe sot e kësaj dite mbahen fshehur. Pos popullit të thjeshtë që ka qenë dashtë të jetë i informuar, për këto procese nuk kanë qenë të informuar në shumicën e rasteve as deputetët e Kuvendit të Kosovës që janë përfaqësues të popullit. Disa e arsyetojnë dialogun (zgjatjen e këtij procesi) kinse për shkak të ndërhyrjes së Kinës dhe Rusisë në këtë proces duke e mbajtur anën e Serbisë. Ekipi negociator e di fare mirë se Kina dhe Rusia janë tërhequr moti nga ky proces.

Problematikat rreth dialogut kanë shkuar edhe më larg, vazhdimisht ka pasur përplasje mes partive lidhur me dilemën a duhet të vazhdohet dialogu me Serbinë pa strategji dhe platformë kombëtare. Dialogu duhet ta ketë një qëllim, ta ruaj sovranitetin dhe integritetin territorial, të ketë unitet shtetëror dhe Kosova të jetë e ranguar me Serbinë si shtete të barabarta në organizatat ndërkombëtare.

Bisedimet në fakt ka qenë dashtë të zhvillohen rreth profilizimit të pakicave serbe në Kosovë, rreth krimeve të luftës, rreth të pagjeturve, rreth resurseve të mëdha ekonomike që ende i menaxhon Serbia siç është "Trepça" e resurse të tjera si "Trepça". Por ekipet negociuese, siç duket, kanë shkuar aq larg saqë janë deklaruar se kemi bërë kompromise të dhimbshme rreth ndarjes së Kosovës dhe dëmtimit të sovranitetit të saj.

Unë mendoj se dialogu duhet të përmbyllet shpejt dhe se të gjitha marrëveshjet që janë bërë në dëm të Kosovës nuk do të jenë të pranueshme siç kanë qenë për Serbinë të pazbatueshme shumica e marrëveshjeve që janë bërë deri më tani. Bisedimet dhe dialogu duhet të kenë një format dhe qasje ndryshe. Popullit po i humbet durimi, e popullit do t'i bashkohemi edhe ne.

Serbia edhe në këtë kohë Kosovën e konsideron zyrtarisht pjesë të vetën dhe ashtu po vepron. Minoriteti serb jeton nëpër enklava dhe nuk e pranon shtetësinë e Kosovës, duke e përjashtuar një grup simbolik nga ky minoritet që e pranon Kosovën, por nuk deklarohet. Paguhet nga buxheti i Serbisë dhe punon më planprograme dhe dokumentacione zyrtare të Serbisë.

Në anën tjetër, jo pak shqiptarë të Kosovës e kanë pranuar shtetësinë e Serbisë, së paku mbi 30 mijë janë të evidentuar si të tillë. Shikoni sa qytetarë të Kosovës e kanë tërhequr shtetësinë, janë mbi 10 mijë njerëz, e të mos flasim sa njerëz kanë azil politik në vendet e Evropës si të përndjekur. Po ashtu, 50 mijë kosovarë të tjerë që ikën nga Kosova në shenjë revolte për shkak të pasigurisë dhe mosperspektivës.

Edhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës vepron në Kosovë administrata e UNMIK-ut e cila e njeh Rezolutën 1244. Për t'i përballuar këto probleme neve na ka munguar strategjia përkatëse dhe ndërtimi i organizmave preventivë. Lojës me pakicat serbe duhet t'i vijë fundi. Pakica serbe është një mekanizëm i instrumentalizuar në duart e Beogradit. Atyre të drejtat e rezervuara po u japin hapësirë për të dominuar mbi 99 për qind të shumicës shqiptare. Në anën tjetër, deputetët e minoritetit serb, edhe sot e kësaj dite, shumica prej tyre nuk e njohin shtetin e Kosovës, por kanë mundësi të vendosin balancë dhe prishin balance sa i përket konceptit të vendimmarrjes për çështje të rëndësishme.

Faktikisht, ky fenomen Kosovës ia ka prishur imazhin në arenën ndërkombëtare.

Serbia pothuajse për ditë e rrezikon stabilitetin e Kosovës, kurse ne kemi heshtur. Gjatë këtyre viteve Serbia e ka provokuar në format më të vrazhda dhe më të padurueshme pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës dhe ne prapë kemi heshtur. Këto janë disa nga shenjat që tregojnë se Kosova po "palestinizohet".

Dialogu duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe të njoftohet populli me vendimet dhe ecurinë e bisedimeve. Në të kundërtën, situatat e deritanishme kanë treguar se Kosova është pronë e një kaste njerëzish të cilët mund të bëjnë çfarë të duan me të. E thashë edhe më parë se marrëveshjet që janë bërë në dëm të Kosovës nuk kanë për të qenë të pranueshme, pasi që aty ku cenohet integriteti i Kosovës derdhet gjak i ri.

Në bisedimet e mëhershme, Edita Tahiri, në bashkëpunim me Jeremiqin dhe negociuesit e tjerë, i përgatitën planet për një autonomie të cunguar, ndoshta të përmasave si të vitit 1945, kur Kosova dhe viset e tjera iu aneksuan Serbisë. Sigurisht se ekipi negociator i Kosovës i ka parasysh rreziqet e mundshme.

Bisedimet me Vuçiqin, të cilat po zhvillohen në fshehtësi, janë të papranueshme dhe paraqesin rrezige të reja për Kosovën. Qytetarët ka kohë që kanë filluar ta humbin besimin në disa prej institucioneve të qeverive të kaluara dhe të kësaj Qeverie. Ky fenomen është bërë i dukshëm para shumë vitesh. Sistemi shumë i dobët i stafit diplomatik ka bërë që Kosova të dështojë në shumë procese zhvillimore të politikave të jashtme. E tillë është loja me shtetet që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, e nën presionin e Serbisë qenkan tërhequr! Stafi diplomatik i Kosovës nuk ka mundur ta tejkalojë këtë goditje që ka ardhur nga Serbia dhe kjo lojë po vazhdon edhe sot.

Pushtetarët tanë dhe strukturat që janë caktuar për ta vazhduar dhe përfunduar dialogun me Serbinë si duket kanë rënë nën ndikimet strategjike të projektit të kryetarit të Serbisë të shifruar, exit strategy (strategjia dalëse), përmes të cilit është paraparë të shtyhet dialogu deri në pakufi apo derisa Serbia t'i mbërrijë qëllimet e veta.

Ushtarët e minoritetit serb në FSK, por edhe në ShPK, marrin pensione nga Beogradi, në disa raste edhe paga. Këtë e tregon më së miri tërheqja e disa pjesëtarëve serbë nga FSK-ja nën presionet e Beogradit.

Serbia përmes ndikimit ekonomik dhe biznesmenëve artificialë-hibridë që i ka krijuar në Kosovë po e shtrinë ndikimin e vet politik në Kosovë. Ky proces po e rrezikon pavarësinë e Kosovës dhe i ka dhënë hapësirë të mjaftueshme depërtimit rus në Kosovë, por edhe në vendet e rajonit, si në Maqedoni, Greqi, Shqipëri, Serbi, Mal i Zi etj. Madje ky proces, bëhet fjalë për ndikimin ekonomik, ka shkuar aq larg saqë është duke u punuar në projektin e ri të rikonsolidimit të Jugosllavisë së re, prapa të cilit qëndrojnë edhe disa politikanë kosovarë, por edhe nga Shqipëria.

Unë mendoj se nuk është mirë të luhet me pavarësinë e Kosovës sikurse u luajt dikur me ndërrimin e Kushtetutës e ky problem u bë shkas për t'u ngritur i madh e i vogël në mbrojtje të Kushtetutës. Prandaj konsultimi është ndër shtyllat e progresit. Mos i bëni gjërat kokë në vete. Populli ju zgjedh juve, por populli edhe ju ndëshkon. Ai është sovrani.

Ndikimi politik i kishës ortodokse në Kosovë dhe shtetet e rajonit i ngjalli ekstremizmat e tjerë fetarë në rajon. Për ta dëmtuar imazhin e Kosovës, Kisha Ortodokse e ndihmoi për t'u fuqizuar vijën e ekstremizmit mysliman për ta paraqitur Kosovën në arenën ndërkombëtare shtet me ndikim islamik. Me këtë letër Serbia ka luajtur disa herë edhe në të kaluarën.

Gjatë historisë të gjitha dyndjet e mëdha i ka organizuar Kisha Ortodokse kundër shqiptarëve. Fillimisht i detyronte shqiptarët ta ndërronin identitetin, kombësinë dhe fenë. Në disa raste, para se të organizoheshin shpërnguljet masive të shqiptarëve, i detyronin të shkruheshin turq, pastaj bëheshin konventat në mes të Turqisë dhe Serbisë për dëbimin e tyre në tokat e shkreta të Anadollit, për t'i populluar ato pjesë. E ka hequr të zitë e ullirit ky popull, por gjithmonë ka dalë dikush që i ka dalë Zot.

Nuk na vlejnë fitoret që e lënë shtetin në disavantazh. T'i mbledhim dhe t'i avancojmë mendjet e ndritura. Njerëz që e duan pa hile këtë vend ka mjaft. Edhe ju që na keni udhëhequr gjerë më tani e keni hisen e madhe në këtë vend, se keni bërë mund e sakrifica të mëdha, por ta udhëhiqni vendin nuk keni ditur.

Serbia duhet ta ndërrojë qasjen ndaj Kosovës, pastaj Kosova ka argumentet e veta për të negociuar. Një vend i enklavizuar si Kosova, me një sistem paralel në të gjitha fushat, me liri të kufizuara në të gjitha hapësirat e këtij territori, me banda e grupe të armatosura e të uniformuara që sillen në Kosovë para syve të BE-së, të politikanëve tanë e para tërë botës, nuk ka bisedime të mirëfillta. Keni kohë të mjaftueshme t'i ndërtoni platformat politike të zgjedhjes së problemit mes Kosovës dhe Serbisë, pastaj bisedimet janë të nivelit të barabartë. Nuk është e pranueshme që bisedimet të bëhen nën presionin e bandave paramilitare dhe ndikimit të brendshëm që e ka shtrirë Serbia në Kosovë. Këshilla e fundit e imja është ta shpëtojmë kombin nga injoranca, korrupsioni e harresa historike. Duhet ta promovojmë Kosovën jo përmes kompanive lobuese, por të bëjmë punë që të lobojmë për to. T'i promovojmë vlerat e popullit shqiptar dhe të lobojmë në botë me këto vlera që janë universale në botë. Duhet të bëjmë aleanca të fuqishme me shqiptarët e Luginës së Preshevës, me shqiptarët e Çamërisë, me ata të Maqedonisë, të Malit të Zi, të Kosovës e të Shqipërisë, me shqiptarët e diasporës që janë pjesa elitare e kombit shqiptar. Mos t'i harrojmë shqiptarët e kolonive të hershme të vendosur në ShBA, Itali, Turqi, Greqi etj. për ta çuar vendin përpara dhe për t'i gjetur rrugët e favorshme të dialogut të Kosovës dhe Serbisë. Ia vlen një sakrificë e tillë.

Fjalë e mbajtur në konferencën shkencore "40 vjet veprimtari shkencore e krijuese të prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha"

# DEKADA TË PUNËS SË FRYTSHME SHKENCORE



Prof. dr. Hysen MATOSHI

Rilindja kombëtare e shqiptarëve, të mbetur nën robërinë jugosllave, si një proces i pandalshëm e gjithëpërfshirës, nisi vetëm në dekadën e katërt të shekullit XX. U dëshmua se ndërgjegjësimi kombëtar pa një shkollë kombëtare ishte i pamundur. U dëshmua se gruaja shqiptare ishte faktor i rëndësishëm në këtë ecje përpara, në këtë hapërim historik që kombin tonë e solli krah për krah kombeve moderne të kësaj hapësire evropiane. Për këtë fakt biografitë e veçanta janë të rëndësishme për historinë tonë të përgjithshme. Prof. dr. Sabile Keçmezi - Basha, me jetëshkrimin e saj të gjertanishëm, identifikon procesin e rëndësishëm të progresit tonë kombëtar të një epoke, është dëshmi bindëse e zotësisë së gruas shqiptare, e personalitetit që thyen klishetë për kinse rolin e kufizuar të gruas në një shoqëri.

Me një numër të vogël vajzash të kohës, ajo që në nismën e rrugës arsimore e krijoi modelin ndikues, i cili me admirim do të ndiqej nga breza të tërë të rinjsh dhe të rejash shqiptare të Kosovës dhe të viseve të tjera etnike. Në një mënyrë krejt të veçantë, duke kërkuar mundësitë e kualifikimit profesional përtej hapësirës sonë etnike, dëshmoi se gruaja shqiptare e kishte vendin e saj meritor në rrjedhat e emancipimit kulturor e social. Krahas këtij fakti, Profesoresha Sabile Keçmezi - Basha, kontributin e saj historiografik do t'ia dedikojë pikërisht kësaj periudhe dinamike e dramatike, në të cilën shkrihen në një tërësi unike ngjarjet tragjike kombëtare me zhvillimet e lavdishme, pësimet masive me arritjet historike, burgu me lirinë, vdekja me jetën. Profesoreshës i ra hise që të shkruante historinë dhe njëkohshëm të bëhej pjesë e kreative e kësaj historie, si dijetare, si intelektuale dhe si veprimtare.

Ndaj, të nderuar kolegë, nuk është një punë e lehtë as për ne që sot do të përpiqemi ta konceptojmë një veprimtari kaq të begatë shkencore e përgjithësisht kombëtare në një paraqitje disa minutëshe. Megjithatë, do të bëjmë përpjekje të theksojmë disa nga veçoritë më karakterizuese të veprës shkencore të koleges sonë.

Së pari, duhet vënë në dukje parimësinë shkencore të kësaj vepre. Sabile Keçmezi - Basha, në punën e saj studimore, rezultatet historiografike i mbështet në referenca faktografike. Pra, dokumentariteti është baza e konstatimeve të saja shkencore. Punimet e shumta studimore, kumtesat e paraqitura në aktivitete shkencore dhe në veprat monografike, në krye të herës, janë bazuar në burime arkivore, përkatësisht në dëshmi të qasshme dhe të vërtetueshme për komunitetin e historiografëve. Veçmas kjo është e nevojshme të pohohet sot, kur gjejmë histori të shkruara nga autorë që nuk kanë hapur qoftë edhe një dosje arkivore, që nuk kanë në shkrimet e tyre as edhe një referencë të besueshme dokumentare. Profesoresha Sabile ka zgjedhur rrugën e vështirë të të bërit shkencë, pra atë të hulumtimeve e të kërkimeve arkivore, e vetëdijshme se rezultatet shkencore është e domosdoshme të jenë të bazuara në to. Njëkohshëm një pjesë e mirë e veprës së saj përbën një koleksion të rëndësishëm të dhënash arkivore, të cilat studiuesve të tjerë, të sotëm dhe sidomos atyre të nesërm, do t'ua lehtësojnë punën në aspektin e identifikimit dhe të gjetjes së burimeve.



Së dyti, në dyzet vjet kontributesh historiografike, Sabile Keçmezi - Basha është marrë me çështje të rëndësishme të historisë sonë të re. Për shumë arsye, të shkruash për ngjarjet më të reja të historisë së një kombi, një shteti, një shoqërie etj., është ku e ku më vështirë sesa të shkruash për periudhat e mëhershme. Kjo për faktin se ende nuk është bërë seleksionimi i qartë ndërmjet asaj se çfarë është zhvillim me peshë historike e çfarë është zhvillim i rëndomtë ditor dhe, në kontekstin tonë social, kjo çështje shfaqet si tejet problematike sidomos për faktin se shumë nga subjektet e ngjarjeve historike vijojnë të jenë të pranishëm, madje edhe faktorë përcaktues, në rrjedhat aktuale shoqërore. Në saje të formimit të saj profesional dhe të etikës shkencore, Sabile Keçmezi - Basha ia ka dalë që, pavarësisht vështirësive të përmendura, t'i identifikojë idetë, proceset, ngjarjet, strukturat organizative, personalitetet që kanë luajtur rol historik në zhvillimet që sollën ndryshimet e mëdha në Kosovë. Kështu, në veprat e saja monografike dhe në punime shkencore e kumtesa të shumta, të cilat, si lëndë studimore shtrihen në harkun kohor të disa dekadave, ajo ka trajtuar organizatat më të rëndësishme politike, programet e tyre, veprimtarinë e mërgatës shqiptare, shtypin ilegal dhe atë të mërgatës, të burgosurit politikë shqiptarë, proceset gjyqësore ndaj organizatave atdhetare dhe ndaj anëtarëve të tyre dhe, ndonëse kryesisht është marrë me sinteza të mëdha, pra me përgjithësime historiografike, gjithashtu ka dhënë edhe dëshmi të portretizimit shkencor të individualiteteve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, të konceptuar në dy modele monografish për Hyrije Hanën dhe për Sulejman Krasniqin.

Së treti, vepra shkencore e Sabile Bashës, e krijuar në një periudhë 40-vjeçare, është ndër më voluminozet në historiografinë shqiptare përgjithësisht. Vëllimi i saj prej rreth 7 000 faqesh është dëshmi e përkushtimit të vazhdueshëm, e punës së palodhshme dhe të bërë me një ritëm të lartë angazhimi. Nëse kësaj i shtojmë edhe faktin që një pjesë e madhe e këtyre kontributeve historiografike janë botuar në format fejtonesh në shtypin tonë, atëherë lirisht mund të përfundojmë se profesoresha Sabile Keçmezi - Basha është emri më i njohur i të sotmes në publicistikën tonë historike. Natyrisht nuk mund të lihen anash as botimet e shumta në periodikun shkencor të Kosovës dhe jashtë saj, sikundër edhe pjesëmarrja në shumë konferenca shkencore të karakterit kombëtar e ndërkombëtar.

Së katërti, përveçse bëhet fjalë për një studiuese me parimësi shkencore, përveçse është marrë me çështje të rëndësishme të historisë sonë, se është ndër penat më produktive të historiografisë shqiptare, Sabile Keçmezi - Basha ka dëshmuar se e zotëron si materie, me një kompetencë të lartë, periudhën e saj studimore. Sintezat që ka bërë, veçmas ato për lëvizjen kombëtare shqiptare dhe periodizimi që ia bën asaj, duke njohur si kufij kthesash ngjarjet dhe proceset e rëndësishme të gjysmëshekullit më dinamik në historinë e shqiptarëve, janë arritje të saja të qëndrueshme dhe rezultate orientuese për këdo që synon të merret me historinë e Kosovës dhe të shqiptarëve përgjithësisht.

Së pesti, krahas punës së palodhshme për realizimin e projekteve shkencore, Sabile Keçmezi - Basha është dëshmuar edhe në sferën e shkrimeve letrare-artistike. Profesionalizimi i vazhdueshëm në shkencën e historisë nuk ia ka zbehur asnjëherë pasionin e lindur për letërsinë. Kam kënaqësinë të konstatoj se në letërsinë shqipe vjen si njëra ndër autoret më tona më të spikatura me 16 vepra letrare. Talentin dhe mjeshtërinë e saj i ka dëshmuar në gjini të ndryshme letrare, si në prozë, dramë dhe veçmas në poezi, ku edhe është vlerësuar më shumë dhe madje edhe është shpërblyer me çmime letrare.

Të nderuar kolegë,

Ndonëse jetojmë në një shoqëri, në të cilën institucione më të larta të dijes fatkeqësisht udhëhiqen nga mendësi skajshmërisht të tribalizuara, në të cilat nuk vlerësohet në mënyrë meritore as edhe kalibri i një dijetareje të tillë, nuk vlerësohet profili intelektual i gruas e cila si e para e mori gradën e doktorit të shkencave në Kosovë, e cila e ka pasuruar me vlera e rezultate dijen dhe kulturën shqiptare me dhjetëra libra dhe qindra studime shkencore, i ka kontribuar zhvillimit të dijes institucionale në Kosovë nëpërmjet punës së palodhshme në Institutin e Historisë "Ali Hadri", megjithatë është një fat i madh që Sabile Keçmezi - Basha vjen në këtë përvjetor me një ritëm të lartë prurjesh shkrimore, përkatësisht me disa botime shkencore e letrare.

I bindur se shumëçka lidhur me vlerat e veprës dhe lidhur me aspekte të personalitetit të Profesoreshës Sabile Keçmezi - Basha ka mbetur pa thënë, dua ta përmbyll këtë fjalë të shkurtër, me urimin që arritjet e saja të vijojnë edhe për shumë e shumë vite.

Njëkohshëm këtij urimi, do t'ia bashkoja edhe urimet e kolegëve të Institutit Albanologjik, me dëshirën që ta vijojmë edhe më tej bashkëpunimin e gjertanishëm.

Urime profesoreshë, urime familjes Basha dhe Institutit të Historisë!

## Nën përkujdesjen e MKRS-së organizohet "Sofra e Gurbetqarëve"

PRISHTINË, 9 KORRIK (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të hënën në një takim pune përfaqësuesit e Ansamblit "Emin Duraku" nga Zhuri, me të cilët ka biseduar për realizimin e organizimit "Sofra e Gurbetqarëve", i cili mbahet për herë të parë si i tillë në Kosovë.

Organizimi planifikohet të mbahet më 31 korrik të këtij viti në Prizren.

Ministri Gashi është pajtuar që ky aktivitet kulturor të organizohet nën përkujdesjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. "Si shenjë mirënjohjeje, falënderimi dhe mikpritjeje për bashkatdhetarët tanë që jetojnë e veprojnë në Mërgatë, e që vijnë e kryejnë pushimet në vendlindje, pa hezitim kam miratuar kërkesën që organizimi kulturor në fjalë të realizohet nën përkujdesjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit", ka thënë ministri Gashi.

Në kuadër të këtij aktiviteti planifikohen të mbahen pika të ndryshme artistike të vlerave të mirëfillta autoktone shqipe por edhe do të shpërndahen mirënjohje për ata që kanë kontribuar për çështjen e shtetësisë së Kosovës në forma të ndryshme.

Mbështetjen e aktivitetit në fjalë ministri Gashi e ka vlerësuar edhe si një përkrahje institucionale për organizatat që merren me veprimtari kulturore në Kosovë.

Përfaqësuesit e Ansamblit e falënderuan ministrin për gatishmërinë e treguar dhe e informuan edhe për punën, planet dhe sfidat me të cilat përballet ansambli.



E rrallë

# Japoni, hoteli me mace në dhomë



Një hotel ku asgjë nuk mungon, madje ka diçka më shumë: një mace në dhomë. Është oferta që u bënë klientëve të saj një hotel, i cili është përuruar së fundmi në fshatin japonez të Hakones. Turisti mund të zgjedhë një mace për të mos qëndruar i vetëm në hotel. Në rrjetin social në "Twitter" janë bërë virale fotografitë e klientëve të kënaqur nga trajtimi me macët.

FOTO E DITES




Në fotografi shihen biçikleta të hedhura në një depo të mbeturinave në Shangai të Kinës. /Reuters/

E jashtëzakonshme

# Britanikët pinë 122 milionë paund birrë gjatë sfidës Angli - Suedi



"Daily Mail" ka shkruar se rreth 38 milionë gota plastike me birrë janë harxhuar gjatë ndeshjes Angli - Suedi. Fitimet e bareve nga kjo ndeshje përllogariten në 100 milionë paund, teksa 3.5 milionë tifozë e kanë ndjekur sfidën në 40 000 lokale të vendit. Ndërkaq Shoqata Britanike e Birrës dhe Pubeve (BBPA) ka njoftuar se nëpër shtëpi 20 milionë të tjerë kanë pirë birra, në vlerë 22 milionë paund.

## BARSOLETA E DITËS



Gjyqtari e pyet dëshmitarin:
- E dini se ç'do të fitoni me dëshmi të rrejshme?
- I akuzuari ma ka premtuar një automobil.

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit
në ora 16:00

### " INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird





Në ora 18:20

### "FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco

Në ora 20:00

### "ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed





Në ora 22:00

### "LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sot mund të ndiheni shumë të kënaqur nga arritjet e projekteve tuaja. Keni ditur se si t'i kombinoni idetë me praktikën në punë.



**DEMI**
Po ecni me hapa të avashtë sa iu përket çështjeve të zemrës. Çdo gjë rreth e qark po ju flet për situata të reja.



**BINJAKËT**
Dita do të nisë me një lajm që si fillim mund t'ju çorientojë disi, por që do të jetë mjaft optimist për të ardhmen.



**GAFORRJA**
Keni preferuar të jeni të drejtpërdrejtë me njerëzit sot, por kjo gjë do t'i lëkundë ndjeshëm raportet tuaja me kolegët.



**LUANI**
Sot jeni të pavendosur lidhur me çfarë do të bëni. Kjo gjë vjen për shkak të mosnjohjes së personave që do të keni përballë gjatë ditës.



**VIRGJËRESHA**
Ndonjëherë mund të veproni edhe pa marrë miratimin e të tjerëve. Nëse vendosni të silleni në një mënyrë të caktuar sot, ndajeni mendjen me veten tuaj.



**PESHORJA**
Po vini në provë personat që keni pranë për të parë nëse janë në përputhje me ato që ju mendoni. Sot do të keni një surprizë të këndshme.



**AKREPI**
Ndonjëherë provoni të dëgjoni edhe ata që ju japin këshilla. Jo gjithmonë keni të drejtë për gjithçka.



**SHIGJETARI**
Po bëni gjithçka që të mos tregoni shqetësimin që ju ka shkaktuar një lajm që sapo dëgjuat. Nëse duhet të veproni duhet ta bëni tani.



**BRICJAPI**
Të gjithë do të mundohen t'ju kënaqin sot. Është një ditë e veçantë për ju dhe kjo gjë ju bën të ndiheni të përkëdhelur.



**UJORI**
Po mundoheni t'i modifikoni planet tuaja për të ardhmen sepse keni kuptuar që janë shumë më ambicioz sesa mundësitë tuaja reale.



**PESHQIT**
Dita sot do të ndryshojë komplet nga ajo që ju kishit parashikuar. E rëndësishme është të mos ju kapë paniku.

# Fejohet Justin Bieberi, Hailey Baldwin tregon unazën



Justin Bieberi i ka dhënë fund beqarisë dhe i ka propozuar për martesë të dashurës së tij Hailey Baldwin. Dhe vajza e aktorit të famshëm, Stephen Baldwin, ka treguar unazën e fejesës në gishtin e saj. Fotografia e modelueses nën shoqërinë e këngëtarit është postuar nga një fans në rrjetet sociale. 21-vjeçarja dhe Justini po shijojnë pushimet në Bahamas.

# E veshur me kostumin e Wonder Woman, Gal Gadot viziton një spital fëmijësh







Gal Gadot ka vendosur që në kuadër të ditëve festive në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ta vizitojë një spital me fëmijë të sëmurë. Aktorja ishte veshur me kostumin e karakterit të saj, Wonder Woman, nga filmi për superheroinën për t'i gëzuar fëmijët. Fëmijët e spitalit Inova në Annandale të Virginias janë mahnitur nga prania e saj. Ajo ka pozuar me fëmijët, si dhe i ka mbajtur në dorë foshnjat, të cilat janë detyruar të qëndrojnë në spital për shkak të sëmundjes.



# Dua Lipa, fansave: Mezi po pres t'ju takoj në Prishtinë

Dua Lipa po vazhdon me sukses të mbajë koncerte anembanë planetit tokë si dhe po regjistron këngë të reja. Tashmë botërisht dihet se Dua do të vijë gjatë muajit gusht në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë. Zeshkania do të performojë para publikut shqiptar në kuadër të festivalit që është organizator i ati i saj, Dukagjin Lipa. Këngëtarja 22-vjeçare ka pohuar përmes një mesazhi në "Instagram" se mezi po pret të këndojë sërish në Prishtinë.

# Ronaldo dhe Georgina shijojnë pushimet



Derisa mediet po spekulojnë vazhdimisht për të ardhmen e tij, Cristiano Ronaldo është duke i shijuar pushimet me familjen. Superylli portugez është duke pushuar në Greqi me të dashurën Georgina Rodriguez dhe fëmijët. Pos një poze intime të çiftit, ata kanë pozuar edhe me djalin e madh të Ronaldos, Cristiano Jr.




# Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | FRANCE - BELGIUM | GG | CROATIA - ENGLAND | 1 | HOME UNITED - YOUNG LIONS | 1 |

# Drita kërkon maksimumin ndaj Malmos

Trajneri Bekim Isufi dhe futbollistët Ardian Limani, Xhevdet Shabani dhe Përparim Livoreka kanë pranuar se Malmo është favorite për këtë ndeshje, por premtojnë se me ndihmën e "Intelektualëve" në stadiumin "Adem Jashari" t'i befasojnë suedezët. Drita në Ligën e Kampionëve ka mundur Santa Colomanin dhe Lincoln Red Impsit

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 KORRIK - Kampionia e Kosovës, Drita, është gati për ndeshjen e fazës së parë të parakualifikimeve për Ligën e Kampionëve ndaj kampiones së Suedisë, Malmos. Kjo ndeshje zhvillohet sonte (e martë) në stadiumin olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë me fillim nga ora 20:45.

Trajneri Bekim Isufi ka thënë se kundërshtari është favorit në këtë ndeshje, por beson se lojtarët e tij do të angazhohen maksimalisht për të pasur një paraqitje sa më të mirë, pse jo për të marrë edhe një rezultat pozitiv. "Është një ndeshje historike jo vetëm për klubin tonë, por edhe për futbollin e Kosovës, sepse dihet sa është dashur të presim për zhvillimin e këtyre ndeshjeve. Kemi pasur kohë të përgatitemi më shumë sesa në dy ndeshjet e para, por dihet se përballë e kemi një kundërshtar të nivelit të lartë. Malmo është favorite, por ne nuk do të dorëzohemi dhe besoj shumë te lojtarët, se do ta japim maksimumin dhe të paraqitemi mirë, aq sa na lejon kundërshtari", ka thënë Isufi. "E mira është se kemi ruajtur boshtin e ekipit nga edicioni i kaluar dhe na janë larguar vetëm dy lojtarë të rëndësishëm, por jemi mundur t'i mbulojmë ato hapësira aq sa na ka lejuar tregu i transferimeve. Për këtë fazë do të ishte mirë të kemi një fond më të madh të lojtarëve", ka deklaruar Isufi.




Ndërsa kapiteni Ardian Limani ka thënë se është shumë i lumtur që numri i tifozëve "Intelektualët" do të jetë i madh në stadiumin "Adem Jashari". "Është një lajm i mirë se numri i tifozëve 'Intelektualët' do të jetë i madh për të na përkrahur. Ky është një motiv shtesë për ne dhe do ta japim maksimumin për ta shpërblyer përkrahjen e tyre", ka deklaruar ai.

Lojtari më i mirë i Dritës, Xhevdet Shabani, ka deklaruar: "Do të jetë një ndeshje shumë e vështirë duke pasur parasysh se kundërshtare e kemi Malmon. Jemi përgatitur gjatë gjithë javës për këtë ndeshje. Besoj se do të marrim një rezultat pozitiv".

Për këtë ndeshje ka folur edhe Përparim Livoreka, i cili ka deklaruar se kundërshtari i së martës është shumë i fortë për t'u mposhtur. "Përballë e kemi një kundërshtar shumë cilësor që e njohin të gjithë, por nuk na frikëson aspak. Do të hyjmë për ta luajtur lojën tonë, pse jo edhe të marrim rezultat pozitiv. Kemi bërë gjëra të mira në këto ndeshje evropiane. Besojmë se do të paraqitemi mirë edhe të martën", ka deklaruar Livoreka.

Drita në këtë edicion në arenën ndërkombëtare e ka mposhtur skuadrën Santa Coloma të Andoras me rezultat 2-0, edhe Lincoln Red Imps FC nga Gjibraltari me rezultat 4-1.

# Franca dhe Belgjika, në kërkim të finales

Dy kombëtaret më të mira në botën e futbollit hë për hë, Franca dhe Belgjika, kërkojnë sonte kualifikimin në finalen e Botërorit "Rusi 2018"

PRISHTINË, 9 KORRIK - Franca dhe Belgjika, dy reprezentacionet që kanë treguar performancën më të mirë në këtë kampionat, kërkojnë sonte (e martë) kualifikimin në finale të Kupës së Botës. Ndeshja fillon nga ora 20:00 dhe zhvillohet në "Saint Petersburg Stadium". Franca kërkon finalen pas vitit 2006, kurse Belgjika e kërkon kualifikimin në finale për herë të parë në historinë e vet. Pas eliminimit të Argjentinës në 1/8 e finales dhe Uruguait në çerekfinale, Franca shihet favorite edhe për ta mposhtur Belgjikën, më pas për ta fituar Botërorin. Megjithatë, të përzgjedhurit e trajnerit Roberto Martinez thyen rekord me eliminimin e Brazilit dhe synimet e mëdha janë edhe në ndeshjen ndaj francezëve. Lajm i mirë për Francën është rikthimi i Blaise Matuidit nga suspendimi, kurse në anën tjetër Belgjikës i mungon anësori Thomas Meunier, i cili u ndëshkua edhe në ndeshjen ndaj Brazilit. Në vend të tij trajneri Martinez pritet ta inkuadrojë Boyatan ose Carrascon.



**FORMACIONET E MUNDSHME**

Franca (4-2-3-1): Lloris; Pavard, Varane, Umtiti, Hernandez, Kante, Pogba; Matuidi, Griezmann, Mbappe, Giroud.

Belgjika (4-4-2): Courtois, Alderweireld, Kompany, Vertonghen, Vermaelen, Carrasco, Witsel, De Bruyne, Chadli, Hazard, Lukaku.

## SHKURT

### Wilshere pas 17 vjetësh largohet nga Arsenali, përforcon West Hamin

West Ham Unitedi e ka zyrtarizuar blerjen e mesfushorit të Arsenalit, Jack Wilshere. 26-vjeçari, i cili është lënë jashtë skuadrës së Southgate për Kupën e Botës, është larguar nga Arsenal pas 17 vjetëve. "Ndihem mirë, diçka e veçantë. Njerëzit do t'i kenë parë fotot e mia me fanellën e West Hamit kur kam qenë fëmijë. Gjithashtu, familja ime dhe disa miq të mi janë tifozë të West Hamit, kështu që të gjithë e kanë pritur mirë këtë transferim", ka thënë Wilshere.

### Matthaus: Mbappe duhet ta fitojë 'Topin e Artë'

Legjenda e Gjermanisë, Lothar Matthaus, beson se ka përfunduar epoka e Lionel Messit dhe Cristiano Ronaldos. Ai mendon se "Topi i Artë" duhet t'i takojë Kylian Mbappes. "Nëse Franca e fiton ose jo Kupën e Botës nuk ka dyshime që Mbappe duhet ta fitojë 'Topin e Artë', pasi ka bërë më shumë se Messi dhe Ronaldo", ka thënë Mbappe.

### Legjenda e Juventusit prezantohet te PSG-ja

Portieri legjendar i Italisë dhe Juventusit, Gianluigi Buffon, është prezantuar në skuadrën e PSG-së. Në fjalët e para si lojtar i kësaj skuadre, Buffoni ka thënë se ndihet i lumtur që është pjesë e kësaj skuadre. "Jam vërtet i lumtur që jam këtu. Presidenti më kërkoi me forcë, kur po planifikoja të ardhmen time. Ftesa për të luajtur këtu ishte një surprizë për mua në fillim të majit. Ndjeva se kisha diçka të rëndësishme për të dhënë, ndoshta edhe për faktin se gjithmonë dëshiroj të mësoj diçka të re. Dua të provoj se jam ende një portier i madh dhe jam i sigurt se do ta dëshmoj këtë. Deri në këtë vit kam luajtur edhe në ekipin kombëtar, kështu që kam qenë konkurrues në nivelin më të lartë", ka thënë Buffoni.

Liga e Kampionëve është pa dyshim objektivi më i madh i tij, edhe i PSG-së. "Është një objektiv madhor, që na bashkon mua dhe PSG-në, por jo një obsesion. Këtu mendoj se mund të rritem, ndërsa klubi ende mund të përmirësohet, ndaj le të aspirojnë për ta fituar këtë trofe. Liga e Kampionëve është një nga objektivat më të rëndësishëm në futboll", ka deklaruar Buffoni.

## Kryetari i ri i FFK-së mbështet përzgjedhësin Challandes

PRISHTINË, 9 KORRIK - Kryetari i ri i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, së bashku me sekretarin e Përgjithshëm të FFK-së, Eroll Salihun, e kanë pritur në një takim përzgjedhësin Bernard Challandes. Kryetari Ademi edhe një herë konfirmoi besimin ndaj përzgjedhësit dhe punës së tij, duke thënë se në asnjë moment nuk do të mungojë përkrahja e tij dhe e KE-së, sepse FFK-ja është shumë e interesuar për një kombëtare të fortë e konkurruese dhe jo të jetë vetëm pjesëmarrëse në evenimentet evropiane e botërore.



# Arago dhe Januzi: Prishtina meriton të kalojmë edhe një raund tjetër

Prishtinë, 9 korrik - Mbrojtësi Jamal Arago ka thënë se Prishtina e meriton të kalojë edhe një raund në Ligën e Evropës. Fituesja e Kupës së Kosovës, Prishtina, të mërkurën nga ora 18:00 përballet me CS Fola Esch nga Luksemburgu. "Kemi arritur deri te një raund tjetër dhe për Prishtinën dhe për çdonjërin që jemi pjesë e Prishtinës është shumë e rëndësishme. Pra, kemi arritur progres duke e kaluar një raund, por ne jemi të fokusuar ta përsërisim të njëjtën gjë ashtu siç bëmë edhe me skuadrën nga Gjibraltari", ka thënë Arago, duke shtuar: "Jemi duke e marrë çdo ndeshje seriozisht, pa i lejuar vetes luksin të mendojmë se kjo apo ajo skuadër ka diçka më shumë apo më pak cilësi apo gjëra të tilla, sepse ne besojmë në vetën tonë dhe përpara e kemi rastin e madh të vërtetojmë që nëpërmjet Prishtinës në Kosovë luhet futboll dhe që ka shumë rëndësi për popullin këtu. Thjesht, është shumë rast i mirë për ne të luftojmë dhe të bindim që jorastësisht kemi kaluar një raund më parë dhe që meritojmë edhe më shumë se kaq".



Për faqen zyrtare të Prishtinës foli edhe sulmuesi Ahmet Jonuzi, i cili ka bërë me dije se kryeqytetasit kërkojnë të kalojnë edhe këtë rreth në garën e Ligës së Evropës. "Meqë e kemi kaluar raundin preliminar, tani është shumë e rëndësishme për ne që të paraqitemi sa më denjësisht edhe në raundin e parë duke shpresuar se do të na përcjellë suksesi edhe në këto dy ndeshje të radhës. Kemi përballë kundërshtar që nuk është për t'u nënvlerësuar. Ma merr mendja shumë më i fortë se Evropa por, sido që të jetë, ne do ta respektojmë çfarëdo kundërshtari që do të jetë, më i fortë apo më i dobët, nuk ka rëndësi. Ndërsa ne do të udhëtojmë ta japim maksimumin me qëllim të kalimit të raundit. Ky është synimi ynë, të paktën", ka thënë Januzi.

# Modriqi, favoriti kryesor për 'Topin e Artë'

MOSKË, 9 KORRIK - Fituesi për këtë vit i "Topit të Artë" duket se do të vendoset nga suksesi në Kupën e Botës dhe njeriu i momentit në Rusi është Luka Modriq. Kapiteni i Kroacisë po bën një Botëror fantastik dhe momentalisht kryeson garën për ta fituar "Topin e Artë". Luka Modriq është njeriu i momentit në Rusi dhe është aktualisht lojtari me më shumë kredenciale për ta fituar "Topin e Artë". Pas ndeshjes së fazës së 1/8 ndaj Danimarkës në vendin e tij në Kroaci filluan që ta shpallnin kandidaturën e mesfushorit të Real Madridit për ta fituar "Topin e Artë", çmimin prestigjioz individual që gjatë dekadës së fundit ka qenë pronë e Messit dhe Ronaldos. Por, pas paraqitjes së shkëlqyer të bërë ndaj Rusisë, kandidatura e tij ka marrë edhe më shumë pikë dhe është diçka që po mendohet nga gazetarët dhe specialistët e futbollit në gjithë botën, shkruan "Shqiptarja". Në përfundim të çerekfinaleve, ku Kroacia kaloi mes katër më të mirave, Modriqi u ndal dhe foli për mediat nga mbarë bota duke u përgjigjur në të gjitha gjuhët, anglisht, spanjisht dhe në gjuhën kroate. Nga të gjithë gazetarët pyetja e parë që i bëhej ishte kjo "A e sheh veten si fitues i 'Topit të Artë?'", dhe kapiteni i Kroacisë u përgjigj: "Është diçka që nuk e kam si obsesion dhe për momentin nuk e mendoj, pasi dua që të arrij në finalen e Kupës së Botës". Pavarësisht se Modriqi tregohet modest, numrat flasin në favor të tij. Luka është shpallur tri herë lojtari i ndeshjes nga 5 të luajtura deri tani. Ndaj Rusisë ishte lojtari që preku më shumë topin, po ashtu ka shënuar te goditjet e penalltive ndaj Danimarkës dhe Rusisë dhe ka shënuar edhe dy gola ndaj Nigerisë dhe Argjentinës. Me Cristiano Ronaldon, Messin dhe Neymarin jashtë Botërorit emrat e tjerë kandidatë për "Topin e Artë" janë Griezmann që fitoi edhe Europa League me Atleticon, Mbappe që fitoi tre trofe me PSG-në. De Bruyne është kandidat potencial, pasi fitoi Premierë Ligën dhe Harry Kane autor i 41 golave me Tottenhamin. Të gjithë këta emra ende në garë për Kupën e Botës dhe me potencial të madh. Ajo që do të ndodhë në ndeshjet finale të Kupës së Botës patjetër se do ta përcaktojë edhe fituesin e "Topit të Artë", por momentalisht këtë garë e kryeson Luka Modriqi.



## SHKURT

### PSG-ja, 270 milionë euro për Coutinhon

Skuadra e PSG-së është gati të ofrojë 270 milionë euro për yllin e Barcelonës, Philippe Coutinho. Lajmi është konfirmuar nga "Mundo Deportivo". Braziliani Coutinho në afatin kalimtar të janarit është transferuar nga Liverpooli në Barcelonë.

### Akhmat Grozny e dëshiron Gavazajn

Ish-futbollisti i Prishtinës, Enis Gavazaj, mund të transferohet në Rusi. Skuadra ku luajnë shqiptarët Bernard Berisha, Odise Roshi dhe Bekim Balaj, Akhmat Grozny ka shfaqur interesim për lojtarin aktual të Skënderbeut.

### Vrsaljko mungon ndaj Anglisë

Kroacia e ka marrë një lajm jo të mirë para ndeshjes me Anglinë në gjysmëfinale të Kupës së Botës. Bëhet fjalë për mbrojtësin Sime Vrsaljko, i cili nuk do të luajë në këtë ndeshje për shkak të një lëndimi që pësoi në ndeshjen ndaj Rusisë. Mbrojtësi i Atletico Madridit ishte titullar i padiskutueshëm në kombëtaren kroate.

### Enrique, trajner i Spanjës

Ish-trajneri i Barcelonës, Luis Enrique, është emëruar trajner i ri i Kombëtares së Spanjës. Enriquen do ta zëvendësojë Fernando Hierron në postin e të parit në kombëtaren spanjolle. Ndërsa Hierro e kishte zëvendësuar Julen Lopetegui, i cili u shkarkua pak para fillimit të Kupës së Botës, pasi kishte nënshkruar kontratë me Real Madridin.

### Hazardi: Kante është mesfushori më i mirë në botë

Ylli i Belgjikës, Eden Hazard, para ndeshjes me Francën, ka thënë se lojtari i Chelseat, N'Golo Kante, është mesfushori më i mirë në botë. "Luaj gjatë të gjithë vitit me Kanten dhe mund të them se ai është futbollisti më i mirë në botë në rolin e tij", ka thënë Hazard, i cili është duke shkëlqyer në këtë kampionat.

### Lippi: Buffoni është dashur të pensionohet te Juventusi

Ish-trajneri i Juventusit, Marcello Lippi, mendon se Gianluigi Buffon është dashur të pensionohej te "Zonja e Vjetër". Portieri italian i ka dhënë fund qëndrimit të tij te "Bianconerët", por edhe pse pritej pensionimi i tij, ai vendosi të vazhdonte të luajë. Nga sezoni i ardhshëm, 40-vjeçari do të jetë pjesë e Paris Saint-Germainit, klub me të cilin ka nënshkruar kontratë dyvjeçare. "Kam folur shumë shpesh me Buffonin në tre-katër muajt e fundit. Gjithmonë i kam thënë: 'Ti vendos, mos prano asnjë këshillë, bëje në mënyrën tënde' dhe ai dëshiron të luajë ende". "Do të më pëlqente që ta kishte përfunduar karrierën te Juventusi, por kjo është çështje personale. Nëse mendon se mund të luajë ende, duhet ta bëjë këtë. Ai do të vazhdojë të luajë derisa ndihet se është numri 1", ka thënë Lippi.

| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
|  | | | | | | Autor: GAZMEND MORINA | NJËSOJ; PO AQ, NË TË NJËJTËN MADHËSI A SHKALLË ME NJË TJETËR | LLOJ GËLQERORI (min.) | NDARJE E VOGËL ADM-INISTRATIVE BRENDA RRETHIT | STUDIM ME KARAKTER KRITIK OSE PUBLICISTIK | BASHKËT. | EPOKA E RE | PO (IT.) | PJESËTARET E NJË SHOQATE | QË ËSHTË NË GJENDJE TË MIRË EKONOMIKE; I ..... | GJENDJE QË KRIJOHET KUR MUNGON PUSHTETI SHTETËROR I ORGANIZUAR | HISTORIANI ROMAK LIVI |
| | | | | | | ARTI I VALLEVE ME FIGURA, QË LUHEN NË SKENË NGA DISA VETA | | | | | | I GJYMTË / KONFERENCË ME KARAKTER NDËRKOM-BËTAR | | | | | |
| | | | | | | PRAROJ | | | | | KËNGËTARI ..... HOXHA (shq.) / QYTET I YNI NË MAL TË ZI | | | | | | |
| | | | | | | FISHEKZJARRI QË HIDHET LART PËR TË DHËNË SHENJA | | | | | | | NËNAT / ZANORE | | | | |
| | | | | | | TITULL PËR OFICERË NË USHTRINË E VJETËR TURKE | | | | QË I PESHON MIRË VEPRIMET A FJALËT; I KUJDESSHËM / I KËPUTUR | | | | | | | ISH FUTBOLLISTI ..... RRAKLI |
| | | | | | | SHTET NË AMERIKËN JUGORE (pashq.) | | | | | | | KASA / BANORET E NJË SHTETI AZIATIK | | | | |
| | | | | | | PUNËTOR I TEATRIT TË KUKULLAVE | | | | | | | | | ILION LIKA / PJESË E MEKANIKËS QË STUDION LIGJET E LËVIZJES SË TRUPAVE | | |
| | | | | | | KALORËS MESJETAR | | | | | | MINISTRY OF ECONOMIC DEVELOPMENT / TEPSIA PREJ BALTE | | | | BASHKËT. / BRITMË E LOPËS | |
| EPOKA E RE | FUTBOLLISTI URUGUAIAN NË FOTO (Barcelona) | KËNGËTARJA ...... TOSKA | KAP DIÇKA TE PJESA E SIPËRME NË NJË GOZHDË | PAGJAKËSI | SLOGAN | ALUMIN, URAN | QË NUK PLO-TPJESËTOHET ME DY (pashq.) / ROK BEND AMERIKAN | | | | FORMË E TË HYRAVE SHTETËRORE (shq.) / ALEANCË | | | | | | |
| PJESË E BANJËS | | | | | | | | DAULLE / BASHKËT. | | | | | | KUMBARË / RUBA, MARAMA | | | |
| GUR METEORIK | | | | | | | | | PROVINCË NË ITALI / ANËTARËSIMI NË NJË ORGANIZATË | | | | | | | AI QË E KISHTE DOBËSI THEMBRËN | PJESËTARI I NJË POPULLI NË SRI LANKË |
| I SHKRIRË (PËR LËNDË TË NGURTA) | | | | | | | | ZANORE / SHTET FEDERAL NË SHBA | | BURG KU MBAHESHIN DËNIMET E RËNDA / PËREMËR PRONOR | | | | | | | |
| SILIC | | | "MOLDE" / NAPOLI, ATALANTA | | | UJIT / LLOJ SHEQERKE | | | | | | GJINI E KRIJIMTARISË LETRARE / AUTORITETI ATOMIK SHQIPTAR | | | | | |
| KËNGËTARJA .... MALAJ | | | | | LAPS / PJESË E FORTË E BUKËS | | | | | | SULMIM / SHKURTABIQ | | | | | | |
| | | | | LLOJ ZOGU KËNGËTAR / FLEGËR | | | | | | | | | KATËR (romak) | LETRARI ASLLANI / INTERESI BANKAR NGA KREDIA | | | |
| SHPEND SHTËPIAK / SHKRONJA TË NJËJTA | | | MAL I MADH NË SHQIPËRI / VOZA E MADHE PËR TË MBAJTUR DJATHË | | | | | | | DASHNOR (bised.) / AKTORI FRANCEZ ..... DELON (shqip.) | | | | | IRMA LIBOHOVA / DUET MUZIKOR KONTROVERS (fem.) | | |
| BASHKËT. | | AKTROJA AMERIKANE .... REID / MODELI I ZVOGËLUAR I NJË OBJEKTI | | | | | TË LUTEM (bised.) | | | | | NJËSI PËR MATJEN E FUQISË SË RRYMËS / TOKË E FEUDALËVE SPAHINJ | | | | ZANORE / PESHORE ME DY KRAHË TË BARABARTË DHE ME DY PJATA | |
| REPER I NJOHUR AMERIKAN | | | | | | | QYTET I YNI NË SHQIPËRI / MI I VOGËL | | | | | | LUMË NË SHQIPËRI / CEREMONITË FETARE | | | | NDESHJE |
| MODELJA KRASNIQI | | | | | SOLISTJA ... BYTYQI / I NDESH | | | | PRINCIPATË ARABE (sh.shq.) / KËNGËTARI POTOKU | | | | | | | | |
| EPOKA E RE | GJAKATARI RAST | | | | | | | E SHASTISURA / ISMET RAMUSHI | | | | | | | | | |
| KA, DEM | | | | TENISTJA BELGE JUSTINE / VARIOLË | | | | | | SËPATË E VOGËL ME TEH TË GJERË / MARC ANTHONY | | | | | EKREM KRYEZIU / "IRLANDA" | | |
| PRIJËS I HUNËVE | | | | | | PËRGËZIM / ZANORE | | | | | VRANËSIRË / BASHKËT. | | | NEGËR / ZANORE | | | |
| "RISANI" | | | SHKENCËTARI .... NJUTON | | | | | KLUB FUTBOLLI ARGJENTINAS ... LORENZO | | | | TRAJNERI TURK FATIH ..... | | | | | |

## UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

**REKTORATI**

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

**Nr. ref.** 128/1 **Data:** 09/07/2018

Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren shpallë:

# KONKURS

**PËR PRANIMIN E STUDENTËVE NË VITIN E PARË TË STUDIMEVE NË NIVELIN BACHELOR, PËR VITIN AKADEMIK**

**2018/2019**

Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, për vitin e parë të studimeve themelore- bachelor, në afatin e parë për vitin akademik 2018/2019, do të pranojë 2 080 studentë, prej tyre 1930 studentë të rregullt dhe 150 me korrespodencë.

Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë kandidatët të cilët e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Republikën e Kosovës dhe në shtete tjera.

Mbi bazë të konsideratave humane, Universiteti "Ukshin Hoti" rezervon të drejtën e pranimit të kandidatëve me nevoja të veçanta.

Mbi numrin e përgjithshëm të studentëve të përmendur më lart, universiteti do të rezervojë të drejtën për regjistrimin e studentëve që i takojnë familjes së ngushtë të dëshmorëve deri në 2% (anëtarë të familjes së ngushtë të dëshmorëve janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët).

Bazuar në UA nr.09/2016 MASHT, Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren do të rezervojë deri në 12% nga numri total i studentëve, për komunitetet pakicë, të cilët do të shpërndahen në mënyrë proporcionale, sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve, për secilin fakultet veç e veç.

Në Universitet do të pranohen edhe studentë nga shtete të tjera, me automatizëm në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHT-i, deri në 3% të numrit total të studentëve.
Kandidatë joshtetas të Kosovës, konsiderohen ata kandidatë që e kanë mbaruar shkollën e mesëm jashtë Kosovës, dhe shtetasit e huaj. Këta kandidatë me rastin e aplikimit, duhet ta dorëzojnë edhe nostrifikimin e diplomës nga institucionet përkatëse. Njohja (nostrifikimi) i diplomave bëhet në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në Prishtinë.
Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetëdeklarim, konsiderohet vepër penale sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR.04/L-082) të Republikës së Kosovës.

**Çdo kandidat mund të konkurrojë vetëm në një program. Studentët aktual të universitetit nuk mund të riaplikojnë në ndonjë program tjetër.**

**MËNYRA E APLIKIMIT DHE ZGJEDHJA E KANDIDATËVE.** Kandidatët duhet ta plotësojnë formularin e aplikimit-ONLINE, nga faqja zyrtare e universitetit www.uni-prizren.com duke printuar aplikacionin së bashku me fletëpagesën.

Kandidatët nuk mund t'i dorëzojnë dokumentet nëse paraprakisht nuk kanë aplikuar online dhe nuk e kanë bërë pagesën. Dokumentet e kërkuar sipas konkursit, dorëzohen në fakultetet përkatëse.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet sipas këtyre kritereve:

1. **Kandidatët që kanë diplomë të shkollës së mesme, por që nuk iu kanë nënshtruar provimit të maturës, si dhe kandidatët të cilët nuk e kanë kryer shkollën e mesme në Republikën e Kosovës:**

***Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100:***
- Deri në 30% të pikëve mund të arrihen nga suksesi në shkollën e mesme dhe
- Deri në 70% të pikëve mund të arrihen nga provimin pranues.

2. **Kandidatët që posedojnë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe që e kanë kaluar me sukses provimin e matures:**

***Numri maksimal i pikëve sipas suksesit dhe provimit pranues është 100:***
- Deri në 30% të pikëve mund të arrihen nga suksesi në shkollën e mesme ;
- Deri në 30% të pikëve mund të arrihen nga provimi i matures, dhe
- Deri në 40% të pikëve mund të arrihen nga provimi pranues.

**Do të pranohen vetëm kandidatët që arrijnë 40% nga numri i pikëve të parapara për provimin pranues. Kandidatët të cilët nuk arrijnë 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të lira sipas konkursit.**

Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues më së shumti në tri lëndë mësimore, të cilat i caktojnë vet fakultetet.
Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve është i barabartë, zgjedhja do të bëhet në bazë të suksesit të përgjithshëm nga shkolla e mesme. Nëse pikët përsëri do të jenë të barabarta, atëher merret suksesi nga lëndët e ngushta profesionale..
Komisionet janë të obliguara që tërë ranglistën e kandidatëve sipas pikëve t'ia dërgojnë rektoratit të universitetit.

**Për aplikim kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:**
*-Certifikatën e lindjes (origjinale).*
*-Letërnjoftimin fotokopje.*
*-Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme(origjinale).*
*-Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme dhe dëftesën e maturës (origjinal).*
*-Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit.*
*-Fletëaplikacionin së bashku me pagesën prej 2.50 €.*
*Shtetasit e huaj, që nuk e kanë mbaruar shkollën e mesëm në gjuhën shqipe, përveç dokumenteve të lartcekura, duhet të paraqesin edhe dëshmin mbi njohjen e gjuhës shqipe.*

**Vërejtje: Ju njoftojmë se dokumentet origjinale nuk mund t'i tërhiqni deri në diplomim, ndërsa nuk mund të aplikoni me dokumente të noterizuara. Prandaj, ju lutemi, fotokopjoni dhe vërtetoni te noteri dokumentet për nevojat tuaja personale.**

**AFATET E KONKURSIT:**

**Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentacionit, bëhet prej 09.07.2018 deri më 17.07.2018 (e Hënë ), nga ora 09:00-16:00 (përjashtuar të dielave). Provimi pranues do të mbahet më 19-20.07.2018, duke filluar prej orës 09:00** (shih tabelën me orarin e mbajtjes së provimit pranues).

**Të gjithë kandidatët që i nënshtrohen provimit pranues duhet të kenë me vete një dokument identifikues (letërnjoftimin , pasaportën, patent shoferin). Gjatë kohës së mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë. Kandidatët duhet të respektojnë dispozitat e kodit të etikës në të kundërtën do të sanksionohen.**
**Orari i mbajtjes së provimit pranues është:**

**Më 19-20.07.2018**

| Nr. | Data | Fakulteti | Programi | Prej | Deri | Grupi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 19.07.2018 | Juridik | Juridik | 09:00 | 10:30 | RR+K |
| 2 | 19.07.2018 | Ekonomik | Administrim Biznesi | 09:00 | 10:30 | RR+K |
| 3 | 19.07.2018 | Ekonomik | Menaxhment Ndërkombëtar | 11:00 | 12:30 | RR+K |
| 4 | 19.07.2018 | Filologji | Gjuhë dhe Letërsi Shqipe | 09:00 | 10:30 | RR |
| 5 | 19.07.2018 | Filologji | Gjuhë dhe Letërsi Gjermane | 09:00 | 10:30 | RR |
| 6 | 19.07.2018 | Filologji | Gjuhë dhe Letërsi Angleze | 09:00 | 10:30 | RR |
| 7 | 20.07.2018 | FSHK | Dizajn Softueri | 09:00 | 10:30 | RR |
| 8 | 20.07.2018 | FSHK | TIT | 11:00 | 12:30 | RR |
| 9 | 20.07.2018 | FSHK | TIT –Tur dhe Bos. | 13:00 | 14:00 | RR |
| 11 | 20.07.2018 | Edukim | Program Fillor | 09:00 | 10:30 | RR |
| 12 | 20.07.2018 | Edukim | Program Parafillor | 11:00 | 12:30 | RR |
| 13 | 20.07.2018 | Edukim | Program Fillor- Bos dhe Tur. | 13:00 | 14:00 | RR |
| 14 | 20.07.2018 | Edukim | Prog. Parafillor- Bos dhe Tur. | 13:00 | 14:00 | RR |
| 15 | 19.07.2018 | FSHJM | Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisi | 11:00 | 12:30 | RR |
| 15 | 19.07.2018 | FSHJM | Agrobiznes | 13:30 | 15:00 | RR |

**Shpallja e rezultateve preliminare do të bëhet më: 23.07.2018 në ora 15:00 në faqen zyrtare të universitetit.**
**Afati për ankesa është më: 24-25.07.2018, ndërsa shqyrtimi i tyre do të bëhet më 26.07.2018 duke filluar nga ora 10:00.**

**Ndërsa shpallja e rezultateve përfundimtare do të bëhet më së largu me datë 27.07.2018.**

**Regjistrimi dhe fotografimi i studentëve të pranuar do të bëhet nga data 30.07.2018 deri më 03.08.2018 prej orës 10:00-15:00** (shih tabelën e mëposhtme).

**Kandidatët të cilët nuk arrinjë të regjistrohen (fotografohen) sipas datave të shënuara do ta humbin mundësinë e regjistrimit, andaj ju lutemi që t'i përmbaheni afateve të caktuara.**

